

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5767  
E premte, 3 maj 2019  
çmimi 0.40 €

## Pacolli paralajmëron dy njohje për Kosovën

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", KIM MEHMETI | FAQE 4-5

## Pa ndërhyrjen e ShBA-së nuk do të ketë zgjidhje në mes të Kosovës dhe Serbisë



Publicisti i njohur shqiptar Kim Mehmeti ka thënë se nuk do të mund të ketë zgjidhje në mes të Kosovës dhe Serbisë pa ndërhyrjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Ai i ka quajtur blerje kohe përpjekjet e Evropës për t'i normalizuar raportet

ndërmjet dy vendeve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mehmeti ka theksuar se Evropa pa ndihmën e ShBA-së nuk ka mundur ta zgjidhë asnjë problem ballkanik. Sipas tij, kjo është dëshmuar në të gjitha luftërat e fundit në këto

hapësira. Mehmeti ka thënë se nga qëndrimi i Amerikës do të varet edhe ideja për shkëmbim territoresh. Ai ka bërë me dije se ideja për shkëmbim territoresh e ka dëmtuar Kosovën më shumë sesa të gjitha lojërat diplomatike serbe

## Veseli paralajmëron formimin e një tribunali për gjykimin e krimeve serbe në Kosovë

Kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë të enjten se shumë shpejt do të iniciohet formimi i një tribunali i cili do t'i gjykojë krimet dhe gjenocidin që shteti serb ka kryer gjatë luftës në Kosovë. Në shënimin e 20-vjetorit të masakrës në fshatin Studime, Veseli ka pohuar se do të nxirret një vendim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që të ketë një tribunal i cili duhet të jetë ose i Kosovës, në rastin më të mirë por, nëse ka hezitime, atëherë të jetë ndërkombëtar

FAQE 7



### Haradinaj thotë se në takimin e Parisit duhet të jetë edhe delegacioni shtetëror

FAQE 7

### AKTUALE

#### DEMOKRACIA E EKSLUDIMIT E UE-SË VERSUS DEMOKRACISË GJITHËPËRFSHIRËSE

F.8

Salihe SALIHU - PhD



#### GAZETARËVE U DUHET NJË SINDIKATË

F.11

Alban ZENELI



#### MBI 200 ZYRTARË TË OSBE-SË DO TË ANGAZHohen PËR ZGJEDHJET NË VERI

F.6

#### U LËSHUA NË QARKULLIM TUNELI NË HYRJE TË MITROVICËS

F.7

### EKONOMI

#### ATK-ja KA NISUR REVOKIMIN E LICENCAVE TË LOJËRAVE TË FATIT

F.9

#### KRYESHEFI I TELEKOMIT U JEP MIRËNJOHJE PUNËTORËVE TË DALLUAR

F.9

### SPORT

#### ARIFAJ: DUKAGJINIT NUK I DUHET BARAZHI PËR SUPERLIGË

F.18



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curez-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)


**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË




**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



**TOP  
PAKO**

-  Komunikim **FALAS**
-  Internet deri në **50Mbps**
-  Televizion Digjital

*Për vetëm 17euro*

## TOP PAKO, PËR TË GJITHË!

TOP Pakot përmbajnë të gjitha shërbimet e nevojshme të komunikimit për biznese të vogla por edhe për familje.

Prej vetëm 17.00€, **10 numra me komunikim FALAS**, PLUS:

- ∞ minuta drejt IPKO-së;
- ∞ SMS;
- Internet në mobil deri në 5GB;
- Televizion digjital dhe Internet deri në **50Mbps**;
- Telefoni Fikse me tarifa standarde;

Për më shumë informata, vizitoni dyqanin më të afërt të IPKO-së.

[WWW.IPKO.COM](http://WWW.IPKO.COM)



## Ambasadorja e re amerikane, Kejt Mari, raporton para Senatit

WASHINGTON, 2 MAJ - Në Komitetin për Marrëdhënie të Jashtme të Senatit Amerikan për të enjten është caktuar dëgjimi i më shumë personave të cilët do të emërohen në funksione të ndryshme, mes tyre edhe ambasadorja e re e ShBA-së në Maqedoninë e Veriut, Kejt Mari Bërns.

Pasi nominimi i saj do të kalojë në Komitet, Bërns duhet ta marrë dritën e gjelbër edhe në Senatit e ShBA-së që të zyrtari-

zohet emërimi i saj. Kejt Meri Bërns është nominuar nga presidenti Donald Tramp për ambasador të ri të Maqedonisë së Veriut pas përfundimit të mandatit të Xhes Bejlit. Ajo është diplomate e karrierës, veteran me 24 vjet stazh pune. Para nominimit ambasador në Shkup, ajo nga shtatori 2017 ka qenë në pozitën zëvendësambasador në Ambasadën Amerikane në Athinë. Flet spanjisht, hungarisht dhe turqisht.

Senati muajin e kaluar ka pasur konfirmim të nominimit të Bërnsit. Ajo atëherë paralajmëroi tri prioritete të cilat do të jenë në fokusin e punës së saj si ambasadore e ardhshme në Shkup - stabilitetit përmes institucioneve të fuqishme, siguri përmes partneritetit dhe promovimit të prosperitetit përmes ndikimit pozitiv me fokus avancimin e të drejtave të njeriut, media të lira dhe tregje të hapura.



## Blerim Reka, votuesve të vet: Më 5 maj dilni e votoni për shpëtimin e procesit euroatlantik

Blerim Reka, i cili në rrethin e parë të mbajtur më 21 prill në garë ka qenë edhe kandidati që ka pasur mbështetjen e opozitës shqiptare, të enjten iu bëri thirrje votuesve të tij që të dalin në votime në rrethin e dytë të zgjedhjeve pasi, sipas tij, në këtë mënyrë do të shpëtohet procesi i integritetit euroatlantik të vendit



PRISHTINË, 2 MAJ (ER) - Të dielën (më 5 maj) në Maqedoninë e Veriut mbahet rrethi i dytë i zgjedhjeve presidenciale. Kandidatë janë: Stevo Pendarovski nga koalicioni qeveritar i udhëhequr nga socialdemokratët e kryeministrit Zoran Zaev dhe Gordana Siljanovska-Davkova, kandidatë e VMRO DMPNE-së opozitare. Mirëpo, këto zgjedhje do të jenë të vlefshme vetëm nëse në votime dalin mbi 40 për qind e trupit të përgjithshëm votues. Pikërisht dalja e votuesve vlerësohet të jetë shumë kritike për këto zgjedhje duke marrë parasysh se në rrethin e parë të votimeve pjesëmarrja ka qenë vetëm 41.79 për qind. Në rrethin e parë të mbajtur më

21 prill në garë ka qenë edhe kandidati që ka pasur mbështetjen e opozitës shqiptare, Blerim Reka.

Reka të enjten u bëri thirrje votuesve të tij që të dalin në votime në rrethin e dytë të zgjedhjeve pasi, sipas tij, në këtë mënyrë do të shpëtohet procesi i integritetit euroatlantik të vendit. Ai mohoi të ketë pasur takime me kandidatët apo liderët partiakë për të mbështetur ndonjërin nga kandidatët për president.

Reka thënë se rreth 80 000 vota për vetëm tri javë në politikë nuk mund të injorohen, sidomos që ato u dhanë në zgjedhjet presidenciale me daljen më të ulët (42 për qind në total, nga 20 për qind në komunat shqiptare)

dhe me pavlefshmërinë më të lartë të fletëvotimeve (rreth 33 000 sosh!). "Këto vota tuaja mbështetën konceptin tim 'Një Republikë për të gjithë': si udha e vetme për NATO dhe BE. Edhe sot po e përsëris atë që e thashë në fillim

të fushatës sime, se nuk do ta lejoj tregtinë me vota. As unë e askush tjetër nuk jemi shitblerës të votave tuaja, prandaj as nuk kemi të drejtë të ndikojmë në atë se për kë duhet të votoni këtë të diel", ka thënë Reka. "Tregtia me votat tuaja është kundër kon-

ceptit tim për Republikën, kundër sundimit të ligjit si shtyllë e saj dhe kundër demokracisë dhe lirisë së qytetarëve. Pse atëherë u dashka të mbahen zgjedhjet, nëse liderët në rrethin e dytë sillen si pronarë të votave tuaja?", ka thënë Blerim Reka.

## Opozita bllokoi rrugët në 12 qarqe

Tiranë, 2 maj - Mbështetës të opozitës, të drejtuar nga kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, u grumbulluan të enjten në rrethrotullimin e Bradasheshit në Elbasan, në një nga pikat e njoftuara për protestën e kësaj pasditeje.

Opozita ka bllokuar në 12 qarqe akset kryesore të rrugëve në vend, në shenjë proteste duke kërkuar largimin e kryeministrit Rama dhe shkuarjen në zgjedhje të parakohshme, për të zhbërë atë që e cilëson shitblerje të votës në zgjedhjet e vitit 2017.

Grupe protestuesish u grumbulluan në rrethrotullimin e

Bradasheshit, por nuk pati bllokim të qytetarëve në trafik, pasi policia ka marrë masa për shmangien e bllokimit, duke drejtuar qytetarët në rrugë alternative. Pak pas nisjes së protestës, mbështetës të opozitës u kanë vënë flakën dy gomave në rrugë. Rrugët e tjera të bllokuara në protestën e të enjtes pasdite janë aksi Shkodër-Koplik në qarkun e Shkodrës, Ura e Drinit në hyrje të Rrugës së Kombit në Kukës, mbikalimi i Milotit në Lezhë, ura në kryqëzimin Burrel - Rrëshen - Klos, Plepat në Durrës në hyrje të autostradës, rruget nacionale në hyrje të Korçës, rruget nacionale në

Fier, pranë urës së Mbrostarit, hyrja e superstradës Vlorë - Levan. Në qarkun e Beratit pati grumbullime në Urë Vajgurore dhe dalje të Beratit dhe në aksin Berat - Ura Vajgurore.

Në qarkun e Gjirokastrës, mbështetës të opozitës dolën në rrugë pranë kryqëzimit të rrugës Përmet - Tepelenë - Gjirokastrë. Në Fier protestuesit kanë çarë kordonin e policisë për ta vazhduar rrugën, ndërsa në Berat protestuesit kanë djegur gomat në mes të rrugës.

Në një prononcim për mediet, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, u shpreh se nuk



dëshironte përshkallëzimin e protestës, por reflektimin e PS-së. "Sistemi është rënë për shkak të kapjes së shtetit dhe çdo segmenti. Një demokraci pa liri, është autokraci, diktaturë. Do të dëshi-

roja të mos kishte përshkallëzim, të shikoja një reagim nga PS-ja, për t'i kthyer vlerat e për ta kthyer në shinat e kushtetueses, në atë komizë të socialdemokracisë", tha Kryemadhi.

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka dhënë detaje të enjten rreth takimit të Parisit që do të mbahet më 1 korrik

## Haradinaj thotë se në takimin e Parisit duhet të jetë edhe delegacioni shtetëror

Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se Kosova duhet të përgatitet për takimin e Parisit, ku do të diskutohet vetëm për dialogun Kosovë - Serbi. Pas mbledhjes së Qeverisë, ai e ka ftuar edhe opozitën që të jetë pjesë e këtij takimi. Sipas tij, në takimin e Parisit, i cili do të mbahet më 1 korrik, do të marrin pjesë presidenti, kryeparlamentari, kryeministri dhe delegacioni shtetëror për bisedime me Serbinë

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 2 MAJ - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se në takimin e Parisit Kosova do të përfaqësohet nga tre liderët institucionalë dhe ekipi negociator. Në një konferencë për media pas mbledhjes së Qeverisë, ai ka thënë se do të ishte mirë që në këtë takim të vijnë edhe përfaqësuesit e LDK-së dhe të LV-së. "Kosova tani duhet ta plotësojë formatin e vet sepse nuk bëhet fjalë për një takim multilateral. Këtu po bëhet fjalë për përfaqësim shtetëror. Prandaj, për dialog, pos udhëheqësve shtetërorë, duhet të jetë edhe delegacioni i mandatuar prej Kuvendit, ose bashkëkryesuesit. Nëse formati është më i vogël, në këtë rast, pos presidentit, kryeparlamentarit dhe mua, duhen të jenë edhe Limaj dhe Ahmeti. Behgjet Pacolli vjen sepse është ministër i Jashtëm dhe kryetar partie. Do të ishte mirë të vijë edhe opozita, LDK-ja dhe Vetëvendosje. Jemi duke shkuar në një proces final dhe serioz të zhvillimeve", ka thënë Haradinaj. Ai ka treguar se ka konfirmuar pjesëmarrjen për këtë takim. "Ne kemi dhënë konfirmim për takimin e Parisit. Unë dhe presidenti kemi konfirmuar pjesëmarrjen. Kam kërkuar prej nikoqirit që nga pala e Kosovës të jenë edhe kolegët (delegacioni shtetëror). Presidenti Macron ka pranuar", është shprehur Haradinaj. Kryeministri ka deklaruar se liderët institucionalë të Kosovës nuk kanë dallime në qëndrime. Sipas

tij, në këtë takim nuk do të diskutohet për taksën që Kosova ka vendosur për mallrat serbe. "Sa iu përket marrëdhënieve Kosovë - Serbi dhe finales së këtij procesi, mendoj se qëndrimet janë formësuar. Pra më nuk shkohet për ndërrim të territoreve apo lëvizje kufijsh, por shkohet për njohje reciproke. Këtu nuk kemi dallime as unë, as presidenti dhe as dikush tjetër i Kosovës. Takimi i Parisit është ndoshta takimi më serioz, sepse është bilateral tani. Kosova për këtë takim duhet të përgatitet, në mënyrë që edhe ne, po ashtu edhe Serbia, ta ndihmojmë vetën", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se edhe ShBA-ja do ta ketë rolin e vet në procesin e dialogut Kosovë - Serbi. "Kuptohet se duhet të koordinohemi me ShBA-në, sepse nuk është vetëm lehtësuese, por edhe garantuese për marrëveshjen përfundimtare dhe në këtë drejtim duhet t'i gjejmë mënyrat e koordinimit", ka theksuar Haradinaj.

### Gjermania i thotë 'po' liberalizimit të vizave

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, gjatë kësaj konference për media është shprehur i bindur se liberalizmi i vizave për Kosovën do të ndodhë shpejt. Ai ka treguar se gjatë qëndrimit në Berlin ministri i Punëve të Brendshme të Gjermanisë, Horst Seehofer, i ka dhënë mbështetje procesit të liberalizimit. Sipas tij, "po-ja" e shtetit të Gjermanisë për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën e lejon atë që t'i urojë qytetarët për liberaliz-



imin e vizave. "Kjo nuk është një 'po' e analizave ose mendimeve, është 'po' e njeriut në detyrë që flet në emër të Gjermanisë, ministrit të Punëve të Brendshme, Horst Seehofer, i cili ka thënë 'po' për vizat. Kini parasysh, ky është vendimi i Gjermanisë. Mos lejoni që për

hir të informimi të drejtë mos me qenë të informuar. Ka thënë 'po' menjëherë. Ka kërkuar aty për aty të caktohen personat përgjegjës që të harmonizohet ana teknike që kur të merret vendimi. Me këtë unë mund t'i them Kosovës veç urime liberalizimi!", ka thënë Haradinaj.

Po ashtu, qeveria në mbledhjen e së enjtes ka themeluar grupin punues për bashkëpunim me Ministrinë Federale për Punë të Brendshme Gjermane dhe për harmonizim të standardeve që ndërliken me liberalizimin e vizave.

## Thaçi: Kam theksuar edhe në Berlin se nuk do të lejojmë ndarje të Kosovës



PRISHTINË, 2 MAJ - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se taksat e vendosur për produktet me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina nuk do të hiqet. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", presidenti Thaçi ka folur edhe për Samitin e Berlinit që, sipas tij, nuk ka nxjerrë ndonjë konkluzion të qartë, derisa kritikoi sërish Bashkimin Evropian për mosunitet. Ndërkaq rolin e Shteteve të

Bashkuara të Amerikës, në procesin e dialogut Kosovë - Serbi, e sheh të pashmangshëm. Thaçi ka thënë se është kundër shkëmbimit të territoreve, por është i bindur që Presheva, Medvegja dhe Bujanoci duhet t'i bashkëngjiten territorit të Republikës së Kosovës. "Presheva, Medvegja dhe Bujanoci mund dhe do të luftojnë që të jenë pjesë e territorit të Republikës së Kosovës, me territorin aktual të shtetit të

Kosovës, duke mos e cenuar asnjë centimetër të territorit të shtetit të Kosovës por, në të njëjtën kohë, kam theksuar edhe në Berlin se nuk do të lejojmë asnjë ide për ndonjë sovranitet të dyfishtë për Kosovën, apo ndonjë ide për ndonjë asociacion me elemente ekzekutive të modelit të Republikës Serbe, sepse kjo nënkupton ndarje të Kosovës, sikundër që nuk do të lejojmë ndonjë model gjermano-gjerman", ka thënë Thaçi.

FLET PËR "EPOKËN E RE", KIM MEHMETI

# Pa ndërhyrjen e ShBA-së nuk do të ketë



Publicisti i njohur shqiptar Kim Mehmeti ka thënë se nuk do të mund të ketë zgjidhje në mes të Kosovës dhe Serbisë pa ndërhyrjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Ai i ka quajtur blerje kohe përpjekjet e Evropës për t'i normalizuar raportet ndërmjet dy vendeve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mehmeti ka theksuar se Evropa pa ndihmën e ShBA-së nuk ka mundur ta zgjidhë asnjë problem ballkanik. Sipas tij, kjo është dëshmuar në të gjitha luftërat e fundit në këto hapësira. Mehmeti ka thënë se nga qëndrimi i Amerikës do të varet edhe ideja për shkëmbim territoresh. Ai ka bërë me dije se ideja për shkëmbim territoresh e ka dëmtuar Kosovën më shumë sesa të gjitha lojërat diplomatike serbe

të varet nga qëndrimi i ShBA-së. Ai ka thënë se kjo ide i shkon përshkati edhe Rusisë dhe ajo do të llobojë që të realizohet, e që pastaj e njëjta formulë të përdoret edhe në hapësira të tjera. "Pra, kjo ide e faktorizon Rusinë në Ballkan, sepse pas korrigjimit eventual të kufirit Kosovë - Serbi detyrimisht do të hapen edhe çështjet kufitare në Bosnje Hercegovinë e Maqedoni", ka theksuar Mehmeti. Ai ka thënë se ideja për shkëmbim territoresh në mes të Kosovës dhe Serbisë, Kosovën e ka dëmtuar më shumë sesa të gjitha lojërat diplomatike serbe. "Dhe jo vetëm Kosova, por edhe e tërë shqiptaria është duke i humbur pozitën e para disa vjetëve në rrafshin ndërkombëtar", ka thënë Mehmeti. Ai ka vlerësuar se Samiti i Berlinit ka për qëllim që t'i japë kohë Ballkanit Perëndimor të shpëtojë nga politikanët që zgjidhjet rajonale i barazojnë me ambicjet e tyre për të mbetur sa më gjatë në skenën politike dhe të shpëtojë nga burrështetasit që ndaj shteteve që drejtojnë, të sillen si ndaj pronës së tyre private.

Mehmeti ka deklaruar se perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor nuk mund ta përshpejtojë askush nga jashtë, përpos neve që jetojmë në këtë pjesë të Evropës. Në këtë intervistë, publicisti Kim Mehmeti ka folur edhe për zgjedhjet presidenciale në Maqedoninë e Veriut, me ç'rast ka thënë se shqiptarët ishin dhe mbetën vetëm 'figurantë'. "Në Maqedoni çdo gjë është e mundur. Jo vetëm në këto, por në të gjitha zgjedhjet presidenciale, shqiptarët e këtushëm ishin dhe mbetën vetëm 'figurantë'. Ky rol i tyre u bë edhe më i dukshëm pasi BDI-ja shqiptare pranoi që censusi për zgjedhjen e presidentit, të bie nga 51 për qind, në 41 për qind, me çka edhe më shumë u defaktorizua vota shqiptare. Kështu që çdo gjë do të varet nga përqindja e votuesve dhe se a do të përmbushet censusi i nevojshëm", është shprehur Mehmeti.

**"Epoka e re":** Z. Mehmeti, si i komentoni zhvillimet në Samitin e Berlinit?

**Mehmeti:** Samiti i Berlinit ka për

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 2 MAJ - Publicisti i njohur shqiptar Kim Mehmeti ka thënë të enjten se përpjekjet e Evropës për t'i normalizuar raportet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë vetëm blerje kohe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se pa ndërhyrjen e

Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) nuk do të ketë zgjidhje në mes të dy vendeve. "Duhet thënë një të vërtetë: kjo Evropë, e tillë siç është, pa ndihmën e ShBA-së nuk ia doli të zgjidhë asnjë problem ballkanik. Kjo u dëshmuar edhe në të gjitha luftërat e fundit në këto hapësira. Evropa ishte ajo që vite me radhë ndërtonte paqe duke biseduar me mjeshtrin e

luftërave dhe 'kasapin e Ballkanit', Millosheviqin. Edhe sot dialogun Kosovë - Serbi ajo e zhvillon me dy presidentët që interes parësor kanë karrierat e tyre politike. Pra, besoj se pa ndërhyrjen e ShBA-së nuk do të ketë zgjidhje dhe se e tërë kjo është vetëm blerje kohë", është shprehur Mehmeti, duke shtuar se edhe sa i përket idesë për shkëmbim territoresh, e tëra do

# zgjdhje në mes të Kosovës dhe Serbisë

qëllim t'i japë kohë Ballkanit Perëndimor të shpëtojë nga politikanët që zgjidhjet rajonale i barazojnë me ambicet e tyre për të mbetur sa më gjatë në skenën politike dhe të shpëtojë nga burrështetasit që ndaj shteteve që drejtojnë, të sillen si ndaj pronës së tyre private. Por, sidoqoftë, ne nuk duhet të vetëgënjemmi se ky samit do të sjellë ndryshime në sjelljen e politikanëve tanë, të cilët të 'fortëve' perëndimorë ua thonë atë që ata duan ta dëgjojnë, e neve na shesin arrogancë dhe mospërfillje. Pra, që kanë sjellje të kundërt nga ajo e qenit që mbron shtëpinë e vet: u lëpihen të huajve dhe e lehin dhe e kafshojnë të vetin!

**"Epoka e re":** Ky samit mund të përshpejtojë perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor?

**Mehmeti:** Perspektivën evropiane nuk mund ta përshpejtojë askush nga jashtë, përpos neve që jetojmë në këtë pjesë të Evropës. Ne që thuajse tri dekada me radhë jemi duke e jetuar vetëgënjimin se do të bëhemi si e tërë Evropa, vetëm duke aprovuar ligje që do t'i pëlqejnë Brukselit, por që nuk do t'i zbatojë askush. Dhe që e 'gëlltitim' gënjeshtrenë që na e 'shiti' BE-ja, se mund të ndërtohet parajsë me muratorë të ferrit. Ne që, mbase, edhe ëndrën që të bëhemi si e gjithë Evropa, e vumë mbrapsht dhe, nga zjarrmia dhe padurimi që të bëhemi si ajo, nuk e pamë me kohë se me shumëçka, Evropa është si gjithë ne. Dhe duke qenë

e tillë, ajo pranoi që 'evropizimin' tonë ta bëjë me këta burrështetas të papërgjegjshëm, që sot e përcaktojnë fatin tonë.

**"Epoka e re":** Sipas jush, do të qartësohet përfundimisht e ardhmja e dialogut Kosovë - Serbi si dhe ideja e shumëpërfolur për korrëgjimin e kufijve?

**Mehmeti:** Duhet thënë një të vërtetë: kjo Evropë, e tillë siç është, pa ndihmën e ShBA-së nuk ia doli të zgjidhë asnjë problem ballkanik. Kjo u dëshmuar edhe në të gjitha luftërat e fundit në këto hapësira. Evropa ishte ajo që vite me radhë ndërtonte paqe duke biseduar me mjeshtrin e luftërave dhe 'kasapin e Ballkanit', Millosheviqin. Edhe sot dialogun Kosovë - Serbi ajo e zhvillon me dy presidentët që interes parësor kanë karrierat e tyre politike. Pra, besoj se pa ndërhyrjen e ShBA-së nuk do të ketë zgjidhje dhe se e tërë kjo është vetëm blerje kohë. Kështu që edhe sa i përket idesë për shkëmbim teritorësh, e tëra do të varet nga qëndrimi i ShBA-së. E në ndërkohë duhet thënë se presidenti i Kosovës është më i përshtatshëm për këto bisedime, ngaqë ai pranon çdo gjë i kërkohet, sepse këto bisedime ai nuk i sheh nga këndvështrimi i interesit të Kosovës, por nga ai i fatit të tij politik. Siç duhet shtuar edhe të vërtetën se kjo ide i shkon për shtati edhe Rusisë dhe ajo do të llobojë që ajo të realizohet, e që pastaj e njëjta formulë të përdoret edhe në hapësira të tjera. Pra, kjo ide e faktorizon Rusinë

në Ballkan, sepse pas korrëgjimit eventual të kufirit Kosovë - Serbi detyrimisht do të hapen edhe çështjet kufitare në Bosnjë Hercegovinë dhe Maqedoni.

**"Epoka e re":** Nga këndvështrimi juaj, si i keni parë zhvillimet në Republikën e Kosovës si në aspektin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar?

**Mehmeti:** Me vetë faktin që presidenti i Kosovës është bartës dhe promovues i idesë për shkëmbim teritorësh, Kosova u kthye thuajse aty ku ishte në vitet e para pas shpalljes së pavarësisë. Sepse u ndërpre procesi i njohjes së saj si shtet i pavarur dhe Serbisë iu mundësua që në vend se të përgjigjet për krimet e bëra në Kosovë, të merret me ambicie territoriale ndaj Kosovës. Sipas meje, ndodhi edhe diçka shumë më tragjike se kaq: shqiptarët e Kosovës u lodhën nga lojërat politike dhe u bënë thuajse të pandjeshëm ndaj fatit të vet kolektiv dhe ndaj të ardhmes së vendit të vet. Dhe, si të tillë, zgjidhjen personale ata tani e shohin jashtë Kosovës, me çka vendi bëhet i pabanueshëm për rininë. Pra, ideja për shkëmbim teritorësh në mes të Kosovës e Serbisë, Kosovën e dëmtoi më shumë se sa gjithë lojërat diplomatike serbe. Dhe jo vetëm Kosova, por edhe e tërë shqiptaria është duke i humbur pozitën e para disa vjetëve në rrafshin ndërkombëtar. Dhe kam frikë se ashtu siç vendosën, e siç thanë në kohën e Enverit - lëri le ta vuajnë paaftësinë e vet

që të shpëtojnë nga një diktator - edhe tani vendet perëndimore janë afër vendimit që të thonë: lëri le ta vuajnë çmendurinë e vet politike, pasi nuk janë të zotët të shpëtojnë nga politikanët e vet skizofrenë, të cilët vendet që drejtojnë, i ndiejnë si arenë ku edhe papërgjegjësia dhe krimi politik mund të shpallen 'vlera' demokratike. E në ndërkohë, njësoj si në komunizëm, kur në 'mëmëdheun' tonë në Shqipëri nuk u gjet asnjë disident që do ta mbronte nderin kolektiv përballë një diktatori që e përbuzi inteligjencën shqiptare, edhe tani nuk kemi thuajse asnjë 'disident' që do të dëshmonte se kultura jonë politike shkon përtej krimit dhe papërgjegjësive së drejtuesve tanë.

**"Epoka e re":** Z. Mehmeti, si i komentoni zhvillimet politike në Maqedoninë e Veriut dhe si e shihni zgjedhjet presidenciale të 5 majit? Ka gjasa që të mos ketë sërish fitues?

**Mehmeti:** Në Maqedoni çdo gjë është e mundur. Jo vetëm në këto, por në të gjitha zgjedhjet presidenciale shqiptarët e këtushëm ishin dhe mbetën vetëm 'figurantë'. Ky rol i tyre u bë edhe më i dukshëm pasi BDI-ja shqiptare pranoi që censusi për zgjedhjen e presidentit të bjerë nga 51 për qind, në 41 për qind, me çka edhe më shumë u defaktorizua vota shqiptare. Kështu që, çdo gjë do të varet nga përbindja e votuesve dhe se a do të përmbushet censusi i nevojshëm.

## Pacolli paralajmëron dy njohje për Kosovën

**EPOKA  
ERE**

**Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 2 MAJ** - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, të enjten para deputetëve të Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, është shprehur i sigurt se liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës do të ndodhë brenda këtij viti. Ai i ka siguruar deputetët se shumë shpejt do të arrijnë njohje të reja për Kosovën. Pacolli ka bërë me dije se në këto ditë pritet njohje nga dy shtete, se nga njëri shtet është marrë konfirmimi dhe tashmë kanë nisur procedurat për njohjen e Kosovës. Gjatë raportimit ministri Pacolli ka treguar se Kosova do të aplikojë për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Ndërsa lid-

hur me ecurinë e anëtarësimit në Interpol, ai ka thënë se do të raportojë në një mbledhje të mbyllur të komisionit.

Raportimi i ministrit Pacolli kishte të bënte me angazhimet diplomatike të Ministrisë për Punë të Jashtme gjatë katërmujorit të këtij viti, përfshirë këtu edhe Samitin e Berlinit.

Ministri Pacolli në mënyrë kronologjike ka njoftuar për marrëdhëniet dypalëshe të vendit tonë, për procesin e njohjeve, diplomacinë ekonomike, marrëdhëniet rajonale, raportet me BE-në, organizatat ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrjen e Kosovës në luftën globale kundër terrorizmit. Ai u është përgjigjur edhe pyetjeve dhe shqetësimeve që kanë ngritur anëtarët e komisionit.

Gjatë këtij takimi anëtarët e komisionit interesim të veçantë kanë shfaqur lidhur me Samitin e Berlinit, përkatësisht qën-



drimin e delegacionit të Kosovës i cili, sipas tyre, nuk ka qenë unik. Duke folur për këtë çështje, ministri Pacolli ka bërë me dije se delegacioni kosovar në këtë Samit ka paraqitur qëndrim unik dhe të koordinuar mirë. Me këtë rast, ai ka thënë se

kërkesa për suspendimin e përkohshëm të taksës për mallrat serbe dhe të atyre nga Bosnjë Hercegovina është përsëritur disa herë nga kancelarja Merkel si dhe nga presidenti Makron. Ai ka thënë se vendosja e taksës është arsyetuar nga presidenti

dhe kryeministri i vendit. Anëtarët e komisionit kanë kërkuar që të njoftohen me shkrim lidhur me konsujt e nderit të angazhuar nga vendi ynë si dhe reformat e brendshme në ministri.

## Mbi 200 zyrtarë të OSBE-së do të angazhohen për zgjedhjet në veri

**PRISHTINË, 2 MAJ** - Shefi i misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadori Jan Braathu, ka vizituar të enjten Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ku është pritur nga kryetarja e

këtij komisioni, Valdete Daka. Në këtë takim ambasadori Braathu ka thënë se OSBE-ja i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së KQZ-së për t'i ndihmuar me këshilla teknike të

nevojshme gjatë procesit zgjedhor në katër komunat në veri. Braathu ka bërë me dije se OSBE-ja do të ofrojë rreth 215 zyrtarë që të ndihmojnë për zgjedhjet e jashtëzakonshme

në veri. Ambasadori Braathu ka thënë se tashmë OSBE-ja ka filluar përgatitjet për këshillat teknike dhe deri me tani bashkëpunimi është mjaft i mirë.



## Në Universitetin e Prishtinës mbahet konferenca ndërkombëtare NETTIES

**EPOKA E RE**

Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 2 MAJ** - Në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" po mbahet konferenca ndërkombëtare NETTIES, me temë "Promovimi i inovacionit dhe TIK-ut në progresin e rritjes ekonomike dhe zhvillimit të vendit".

Kjo konferencë, e organizuar nga Universiteti i Prishtinës në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare për e-Shkencë (IAFeS), ka mbledhur studiues dhe akademikë nga vende të ndryshme të botës për të diskutuar lidhur me tematikën e këtij edicioni.

Në hapjen e kësaj konference të pranishmëve iu drejtua me fjalë rasti rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. dr. Marjan Dema, i cili u ka uruar mirëseardhje pjesëmarrësve dhe u shpreh i lumtur që kjo konferencë po mbahet në hapësirat e UP-së. "Ju uroj mirëseardhje të gjithë juve që jeni zgjedhur si pjesëmarrës në këtë konferencë. Njëherësh, shfrytëzoj mundësinë për ta falënderuar Shoqatën Ndërkombëtare për e-Shkencë



që ka zgjedhur universitetin tonë si partner kryesor për organizimin e kësaj konference", ka thënë rektori Dema. Ai ka vlerësuar faktin se konferenca NETTIES mbështet konceptin e interdisiplinaritetit, duke theksuar se ky aktivitet është një mundësi e artë që të diskutohet

për fusha të ndryshme të cilat janë në interes të pjesëmarrësve dhe shoqërisë.

Në këtë organizim foli edhe presidenti i IAFES-it, Radu Vasu, njëherësh rektor i Universitetit Politeknik të Timishoarës, i cili u shpreh i lumtur që edicioni i 17-të i kësaj

konference po mbahet në Prishtinë. Ai ka thënë se Kosova ka shumë potencial dhe ka nevojë që këtu të promovohen ide të reja nga fusha të ndryshme. "Jam i lumtur që jemi këtu për të promovuar ide të reja nga secila fushë, duke përfshirë atë të ekonomisë, e

cila e ndërton të ardhmen e vendit", ka përfunduar ai.

Kjo konferencë mbahet çdo vit në vende të ndryshme të botës, ndërkaq edicioni i sivjetmë po mbahet në Universitetin e Prishtinës.

Konferenca NETTIES do të zgjasë tri ditë me radhë.

## Prokuroria Themelore në Prishtinë organizoi trajnimin me temë 'Dhuna në familje'



**PRISHTINË, 2 MAJ (ER)** - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka mbajtur trajnimin me temë "Dhuna në familje", të organizuar nga koordinatorja për rastet e dhunës në familje, Shenaj Berisha, prokurore e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, në mbështetje financiare nga OSBE-ja, me pjesëmarrje të bashkëpunëtorëve profesionalë të Prokurorisë Themelore të Prishtinës dhe bashkëpunëtorëve profesionalë të Prokurorisë së Shtetit.

Në këtë punëtori ka folur kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Imer Beka, kurse në cilësinë e ligjëruesve ishin prokurorja e kësaj prokurorie, Shenaj Berisha dhe Valentina Bejtullahu-Turjaka, zyrtare nacionale e programit, Misioni i OSBE-së në Kosovë, ndërsa trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga Policia e Kosovës e ka përfaqësuar major Tahire Haxholli. Gjatë këtij trajnimi u diskutua për fenomenin e dhunës në familje, për trajtimin e rasteve të dhunës në

familje në procedura civile dhe penale, si dhe njoftimi i pjesëmarrësve të këtij trajnimi, me hyrjen në fuqi të Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës, konkretisht me nenin e posaçëm për veprën penale "Dhunë në familje", neni 248 i KPRK-së.

Në fund të këtij trajnimi u nxorën konkluzione për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe për luftimin e kësaj dukurie negative si dhe pjesëmarrësit e këtij trajnimi u pajisën me certifikata.

## Në OKUK mësojnë për shenjat klasike dhe zhvillimet e reja në diagnostikimin e sëmundjeve në mushkëri

**PRISHTINË, 2 MAJ (ER)** - Në kuadër të programit të Klinikës së Radiologjisë për edukim të vazhdueshëm profesional të akredituar nga Oda e Mjekëve të Kosovës, të enjten prof. dr.

Maksim Çela nga Tirana, para radiologëve dhe pulmologëve ka prezantuar temën "Shenjat klasike dhe zhvillimet e reja në diagnostikimin e sëmundjeve në mushkëri".

Prof. Çela, si doajen dhe ekspert i njohur në imazherinë radiologjike moderne, ka prezantuar përvojat shkencore dhe të arriturat e fundit nga fusha e radiologjisë. Pas ligjëratisë prof. Maksi ka

demonstruar praktikisht pjesën e ligjëruar e cila ka dhënë rezultat menjëherë pas një ore. Radiologët në Klinikën e Radiologjisë kanë diagnostikuar me ultratingull një pacient me patologji në mushkëri.



# Veseli paralajmëron formimin e një tribunali për gjykimin e krimeve serbe në Kosovë

Kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë të enjten se shumë shpejt do të iniciohet formimi i një tribunali i cili do t'i gjykojë krimet dhe gjenocidin që shteti serb ka kryer gjatë luftës në Kosovë. Në shënimin e 20-vjetorit të masakrës në fshatin Studime, Veseli ka pohuar se do të nxirret një vendim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që të ketë një tribunal i cili duhet të jetë ose i Kosovës, në rastin më të mirë por, nëse ka hezitime, atëherë do të jetë tribunal ndërkombëtar

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**VUSHTRRI, 2 MAJ** - Presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë marrë pjesë të enjten në shënimin e 20-vjetorit të masakrës në fshatin Studime të Vushtrrisë, ku edhe kanë bërë homazhe në kompleksin përkujtimor të varrezat e 117 martirëve. Presidenti Thaçi ka thënë se jemi tubuar sot në 20-vjetorin e masakrës prej më të mëdhave në Kosovë që ka ndodhur këtu në Studime. "Kaluan 20 vjet dhimbje dhe lot. 20 vjet pritje, por në të njëjtën kohë forcë dhe krenari. 20 vjet të përpjekjeve tona për konsolidimin e lirisë dhe forcimit të shtetit të Kosovës. Por, përsëri kjo dhimbje është e patejkalueshme", ka thënë presidenti Thaçi.

Kreu i vendit ka thënë se Serbia me këto masakra ka vulosur gjenocidin në Kosovë. "Kuvendi i Republikës së Kosovës besoj se së shpejti, siç është propozuar nga kryetari Veseli, do të nxjerrë një rezolutë që e dënon gjenocidin e Serbisë të kryer në Kosovë. Jo

vetëm që e dënon, por në të njëjtën kohë do të kërkojmë që drejtësia të vihet në vendin e duhur", ka shtuar ai.

I pari i Kosovës ka shprehur falënderimin e tij për Kongresin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe për mikun e madh të kombit tonë, kongresmenin Eliot Engel, që dha mundësinë të prezantohet gjithë ajo masakër, vuajtje, dhimbje dhe gjenocidi i Serbisë i kryer në Kosovë. "Nga ky vend sot përsëri dëshirojmë ta falënderojmë Kongresin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mikun e madh të kombit tonë, kongresmenin Eliot Engel, që dha mundësinë të prezantohet gjithë ajo masakër, vuajtje, dhimbje dhe gjenocidi i Serbisë i kryer në Kosovë. Edhe ato diskutime të dhjetëra kongresmenëve ishin unike. Mosndëshkimi i gjenocidit serb në Kosovë është një selektim në drejtësi, por edhe amnisti ndërkombëtare për gjenocidin e kryer në Kosovë", ka theksuar ai. Presidenti Thaçi ka thënë se si institucione do të bëjnë gjithçka që është e mundur por, sipas tij, gjithçka që mund të bëjnë në



raport me Serbinë do ta bëjnë në partneritet të ngushtë edhe me ShBA-në dhe me të tjerët por, para së gjithash, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se shumë shpejt do të iniciohet formimi i një tribunali i cili do t'i gjykojë krimet dhe gjenocidin që shteti serb ka kryer gjatë luftës në Kosovë. "Kjo është edhe arsyeja pse në Kuvend do të kemi një rezolutë, dhe jo vetëm rezolutë, por edhe iniciativë që ka të bëjë me drejtësinë, e cila i vë para përgjegjësisë ata të cilët i kanë kryer këto krime. Sot veç kam filluar takimet në Kuvend, me organet tona të drejtësisë, prokurorinë, gjyqësinë, me shoqatat e të pagjeturve e të viktimave të luftës, për të shkuar deri në fund, duke nxjerrë një vendim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që të ketë një tribunal i cili duhet të jetë ose i Kosovës, në rastin më të mirë, por nëse ka hezitime, atëherë do të jetë tribunal ndërkombëtar për krimet të cilat i ka kryer Serbia mbi popullatën shqiptare. Ne nuk do të ndalemi derisa të dalë e vërteta dhe ajo është vetëm një: krimet në Studime dhe të gjitha masakrat e tjera i ka kryer shteti serb dhe

kryerësit e këtyre krimeve, pjesa më e madhe e tyre, sot janë gjallë në Serbi. Ata duhet të përgjigjen për krimet e tyre", ka thënë kryeparlamentari Veseli.

Ai ka theksuar se shteti serb dhe forcat ushtarake, policore dhe paramilitare kanë kryer 186 masakra në gjitha vendet e Kosovës. "Ka 20 vjet që kalojmë nëpër këta përvjetorë. Janë dhimbje, lot, janë edhe krenari, janë edhe pakënaqësi, mllef, frustrim, për faktin se ne për çdo vit përkujtojmë fatkeqësitë e rënda të cilat i kanë ndodhur kombit tonë. Por, njëkohësisht, e dimë edhe kush i ka bërë. Nuk është vetëm masakra e Studimes. Janë kryer 186 masakra në tërë Republikën e Kosovës. Janë 186 krime. Janë varrosur e rivarrosur. Një pjesë e tyre ende nuk e dimë ku janë. Do të thotë, kemi të bëjmë me një krim, me një gjenocid të cilin e ka kryer shteti i Serbisë, me organizimin e vet ushtarak, policor dhe paramilitar, të kontrolluar plotësisht nga kreu i Beogradit", është shprehur ai. Sipas Veselit, e gjithë kjo ka vetëm një shpagim. "Jo hakmarrje, jo revansh, jo konflikt. Ne nuk duam hakmarrje, nuk duam revansh, nuk duam konflikt, nuk duam luftë, jo vetëm me Serbinë, por me askënd. Duam paqe, por

edhe shpagim në bazë të drejtësisë ndërkombëtare", ka thënë Veseli.

Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka theksuar se ndodhet në një vend që flet vetë, në vendin e 117 njerëzve të pafajshëm të pushkatuar e masakruar, por edhe të gjallë e të keqtrajtuar dhe ku ende nuk ka ndodhur drejtësia dhe nuk ka të dënuar. "Përpos faktit që nuk është vendosur drejtësia për martirët e Studimes, e për plot të tjerë, ata që i kanë kryer këto krime kanë filluar t'i mohojnë ato dhe po provojnë ta bindin botën që nuk i kanë bërë këto krime", tha kryeministri Haradinaj, duke shtuar se për institucionet e vendit kurrë nuk është vonë të jenë të bashkuara dhe të vendoset drejtësia për të gjitha viktimat, për të gjithë ata që janë flijuar dhe vranë padrejtësisht.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se është një ndjenjë e dhimbjes që të përshkruhen të gjitha ato që i kalojnë familjet edhe pas 20 vjetëve, por shprehu gatishmërinë që të jetë bashkë me komunën në mënyrë që ky vend, ku pushojnë martirët, të kthehet në një memorial të respektuar dhe që të gjithë të ndihen krenarë për përkujdesjen shtetërore të këtij memoriali.



## U lëshua në qarkullim tuneli në hyrje të Mitrovicës

**MITROVICË, 2 MAJ (ER)** - Zëvendësministri i Infrastrukturrës dhe Transportit, Rexhep Kadriu, mori pjesë të enjten në përirimin e tunelit në hyrje të Mitrovicës. Zëvendësministri Kadriu ka thënë se duke pasur parasysh faktin që për 50 vjet asnjëherë nuk është investuar në këtë tunel dhe pas shembjes së kurorës së tunelit vitin e kaluar,

rinovimi i tij ka qenë i domosdoshëm për të gjithë ata që e frekuentojnë këtë rrugë. Ai ka shtuar se edhe vonesa për përrbyllje të punimeve është bërë shkaku i intervenimeve të nevojshme shtesë, sipas standardeve më të larta për evitimin e rreziqeve që kanë ekzistuar paraprakisht në tunel. Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, e ka

falënderuar ministrinë për këtë punë të shkëlqyeshme dhe të nevojshme në këtë tunel. Ky tunel ka gjatësi prej 250 metrash, me gjerësi prej 6.5 metrash, kurse vlera e investimit për riparimin e tij është afër 380 mijë euro. Tuneli është punuar sipas parametrave të parapara për këtë kategori tunelesh dhe ka tërë infrastrukturën e nevojshme.





# Demokracia e ekskludimit e UE-së versus demokracisë gjithëpërfshirëse



Salihe SALIHU - PhD

Demokracia si një nocion është njohur qysh nga antika dhe që atëherë është debatuar dhe debatohet rreth konceptit demokraci edhe në ditë e sotme. Në këtë sfond të së drejtës për të debatuar është momenti që ta shohim demokracinë e proklamuar në nivelin e UE-së.

Unioni Evropian si bërthamë kryesore e ka rritjen dhe fuqizimin e demokracisë gjithëpërfshirëse si një komponent në konstelacionin e sistemit demokratik dhe synon që të udhëhiqet me vlera të demokracisë. Zgjerimet e UE-së gjatë viteve të 1970 e deri në mesin e viteve 1990 ishin bërë nga shtetet që në një farë mënyre i dhanë një dosje të

përforcimit të këtyre vlerave demokratike, si për shembull anëtarësimi i Britanisë së Madhe, Irlandës dhe Danimarkës në vitet e 1970-ta apo anëtarësimi i Austrisë, Suedisë e Finlandës gjatë mesit të viteve 1990.

Në këto përpjekje UE-ja me hap të ngadalshëm ka arritur goxha të mbërthen në gjirin e vet edhe shumë shtete tjera që kanë qenë formësuar me vlera diametralisht të kundërta me ato demokratike, gjegjësisht me vlera të sistemit komunist e që u transformuan në sisteme demokratike.

Prandaj, zgjerimet e më vonshme nuk ishin të lehta për UE. Në veçanti zgjerimi i vitit 2004 kur u anëtarësuan në një pako shtetet Baltike dhe shtetet e Europës Lindore dhe Qendrore. Në këtë kohë pati shumë kundërshtime nga shtetet që ishin pjesë e UE-së që përcilleshin me frikë dhe dilema se pranimi i këtyre shteteve post-komuniste në Unionin Evropian do ta çekulibronte stabilitetin e tërë Unionit.

Rreth mënyrës së pranimit të

këtyre shteteve post-komuniste si anëtare kishte shumë zëra kundërshtues nga shtetet që ishin anëtare. Në mesin e këtyre shteteve kundërshtarë ishte edhe shteti Suedez kur kryeministri suedez i asaj kohe Goran Persson shprehi ndrojtjen e tij se tani shtetasit e vendeve të sapo pranuar do të bëheshin turistë social duke aluduar se shtetasit e shteteve që do hynin në UE do ti shfrytëzonin mirëqenien e shteteve tjera të Unioni Evropian.

Vërtetë dominonte një frikë për këtë zgjerim, imagjinoni vetëm popullata e Polonisë ishte 40 milionë banorë pa hy me llogarit Hungarinë, Sllovinë, Çekinë e vendet tjera. Të gjitha këto shtete kishin emërues të përbashkët, ishin të përfshira me një krizë të rënd ekonomike dhe kishin kaluar në tranzicion nga sistemi komunist në sistem demokratik, pra shtete post-komuniste.

Përkundër vështirësive dhe kritikave të ashpra që u paraqitën për politikën e zgjerimit të UE-së gjatë kësaj periudhe u hapa paketa e re e anëtarësimit edhe

për Bullgarinë dhe Rumaninë në vitin 2007.

Në këtë rrjedhë të ngjarjeve shohim se UE-ja në këtë kohë paraprihej nga vullneti politik me demokraci gjithëpërfshirëse dhe këtu qëndron e gjithë bërthama për ta drejtuar dhe udhëhequr zgjerimin e UE-së.

Ky vullnet politik brenda UE-së që parashihet të inspirohet nga politika me demokraci gjithëpërfshirëse ka dështuar dhe në vend të saj po dominon demokracia e ekskludimit duke zbatuar politikë selektuese. Kjo dëshmon se influencimet e shumta nga shtetet që kanë frymë armiqësore kundrejt demokracisë gjithëpërfshirëse ka filluar të afektojë edhe brenda politikës zgjeruese të UE-së. Nga këto influencime të dëmshme është prekur më së rëndi Republika e Kosovës duke ngelur si i vetmi vend në Evropë pa liberalizim të vizave dhe me një prolongim të procesit integrujes.

Republika e Kosovës me gati dy milionë banorë nuk paraqet asnjë rrezik për shtet të UE-së, porse është veç pretekst për ta

justifikuar mosvullnetin politik të disa krerëve udhëheqës brenda UE-së. Kosova nuk duhet të ndëshkohet nga UE-ja sepse UE-ja është përgjegjëse për ta ndihmuar sigurinë dhe stabilitetin e vendit dhe kjo realizohet duke e përkrahur Kosovën me hapa të shpejtë drejt UE-së. Me Kosovën brenda UE-së do të eliminohejshin të gjitha pretendimet dhe do të qartësohejshin linjat për tërë rajonin ballkanik duke e siguruar stabilitetin e kësaj pjese të Evropës. Kosova nuk duhet të ekskludohet por duhet të inkludohet në UE.

Udhëheqësit e UE-së e dinë fort mirë që kjo frymë ekskluduese është e dëmshme për t'u instaluar brenda qarqeve të Unionit Evropian dhe duhet të marrin masa operative për ta ndryshuar këtë katandisje.

Fryma e demokracisë ekskluduese është faktor i vetëshkatërrimit të UE-së. Në këtë drejtim Unioni Evropian duhet të tërhiqet sa më parë nga demokracia ekskluduese dhe të dalë me platformë që mbrojnë demokracinë gjithëpërfshirëse.

## Gazetarëve u duhet një sindikatë

Një organizim sindikal i gazetarëve në Kosovë do të ndihmonte që fillimisht të bëheshin të qarta raportet në mes të punëtorëve dhe pronarëve të mediave në aspektin individual, më vonë edhe në raport të të drejtave kolektive të shprehura nëpërmjet një kontrate



Alban ZENELI

Kosova ka shënuar ngritje prej tre vendesh në indeksin e Reporterëve pa Kufi për vitin 2019 por, sipas këtij raporti, liria e medias në vendin tonë vuan ende nga mungesa e stabilitetit. Në këtë fushë duhet të diskutojmë edhe një problematikë që zakonisht nuk trajtohet nga këto raporte, për lirinë dhe të drejtat e gazetarëve si punëmarrës karshi pronarëve të bizneseve mediale ose punëdhënësve.

Problemet që gazetarët hasin në këto raporte janë të mëdha, nëse i hedhim një sy publikimit të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës që flet për lirinë e

mediave dhe gazetarëve, janë evidentuar raste të punës pa kontrata, censurës së gazetarëve nga punëdhënësit e probleme të tjera. Përtej këtij raporti, nëse e trajtojmë qëndrueshmërinë e vendeve të punës së gazetarëve, dalin edhe probleme të tjera. Së pari, kontratat afatshkurtra njëvjeçare ose edhe më të shkurtra me mediat bëjnë që gazetarët të ndihen të pasigurt në vendet e tyre të punës, rrjedhimisht kjo ndikon për të keq edhe në performancën e tyre në punë.

Duke përjashtuar disa media, gazetarët dhe punonjësit e tjerë të mediave punojnë me vetëm një ditë pushimi në javë, gjë e cila është edhe në kundërshtim me Ligjin e Punës. Kjo mund të ketë ndikim edhe në cilësinë e prodhimit medial që bëhet nga këta gazetarë.

Edhe mungesa e kushteve të punës, siç është rasti i mjeteve të duhura për të përcjellë ngjarje që kanë mundësi të

jenë të dhunshme; demonstratat, protestat, e raportimet nga terrene jo të zakonshme, është një shqetësim që duhet të trajtohet nga punëdhënësit. Rastet e mëhershme të raportimit në këtë fushë kanë shfaqur një mungesë të theksuar të këtyre pajisjeve, siç janë: shenjat identifikuese për punëtorëve të medias, helmetat mbrojtëse etj., gjë e cila i ka ekspozuar ata përballë rreziqeve të ndryshme.

Pastaj, duke shtuar këtu edhe rastet e shpëputjeve të njëanshme të kontratave të punës nga ana e mediave, e bëjnë të domosdoshme nevojën e një organizimi kolektiv të mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve të mediave në Kosovë.

Aktualisht, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, që është organizata më aktive për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve dhe medias dhe organizatat e tjera të kësaj natyre, janë në statusin e Organizatave Joqeveritare (OJQ) dhe, rrjedhimisht, përkundër përpjek-

jeve, nuk mund ta zëvendësojnë rolin e një sindikate që do t'i mbrojtë të drejtat e gazetarëve dhe punëtorëve të tjerë të mediave, si: fotografëve, kameramanëve, montazherëve etj., në raport me punëdhënësit e tyre.

Një shembull i tillë i organizimit të mirë sindikal të punëtorëve të mediave është Britania e Madhe, vend në të cilën Sindikata Kombëtare e Gazetarëve (SGK) është themeluar qysh në vitin 1907 dhe ka një rol të theksuar në mbrojtjen e të drejtave të kësaj kategorie. Njëkohësisht kjo sindikatë është më e madhja në botë që përfaqëson këtë komunitet.

Një organizim sindikal i gazetarëve në Kosovë do të ndihmonte që fillimisht të bëheshin të qarta raportet në mes të punëtorëve dhe pronarëve të mediave në aspekt individual, më vonë edhe në raport të të drejtave kolektive të shprehura përmes një kontrate. Ky organizim sindikal do të duhej t'i përfshinte punëtorët e mediave private dhe publike në Kosovë. Struktura organizative e saj do të mund të ndërtohej sikur në shembullin e SKG-së në Britani të Madhe, ku punon-

jësit janë të ndarë në bazë të profesionit, apo në një strukturë tjetër organizative që fillon nga secila redaksi e mediave në Kosovë.

Ky organizim fillimisht do të mund të ofronte mbrojtje sindikale në të cilën përfshihet edhe përfaqësimi ligjor në rastet e kontesteve në mes të punëtorëve dhe pronarëve të mediave. Pastaj, në fazat e tjera, ky lloj organizimi sindikal do të mund t'i ndihmonte gazetarët edhe në aspektet e tjera, siç janë mësimi tërëjetësor, trajnimet e specifikuar për profesionet me ndryshime të mëdha teknologjike brenda mediave etj.

Në plan më të gjerë, ky lloj organizimi do të ndihmonte që gazetarët të jenë më të sigurt në vendet e tyre të punës, të punojnë me më pak presion të vullmit të punës dhe me më shumë kualitet, ta luftojnë censurën dhe autocensurën në punën e tyre. Krejt këto përmirësime të statusit social të gazetarëve do të ndihmonin, po ashtu, shoqërinë tonë, që rangimet e ardhshme të organizatave ndërkombëtare, mediat të quhen të qëndrueshme dhe të operojnë si një faktor i rëndësishëm shoqëror.

## Lirohet drejtori i KEDS-it nga akuzat për rastin 'Kohler'

PRISHTINË, 2 MAJ (ER) - Gjykata e Apelit ka liruar nga të gjitha akuzat drejtorin e KEDS-it, Avni Alidemaj, bëhet me dije nëpërmjet një komunikate për media. "Gjykata e Apelit e ka vendosur drejtësinë në vend. Ajo ka vërtetuar vendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës që e kishte liruar nga të gjitha akuzat KEDS-in në rastin e njehsorëve 'Kohler'. Të njëjtën kohë Gjykata e Apelit ka liruar nga të gjitha akuzat edhe

zyrtarin e KEDS-it, Avni Alidemaj, duke vërtetuar se gjithçka ndaj tij ishte e pabazuar. Gjykata e Apelit ka vërtetuar se edhe ankesa e Prokurorisë ishte e pabazuar për Alidemajn", thuhet në komunikatën për media. Gjykata ka vlerësuar se asnjëra nga provat nuk ka vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprë penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.

Konstatimi i Gjykatës shkon tutje, duke hequr çdo dilemë dhe bregë të konsumatorëve të thirrur si dëshmitarë, pasi nuk është dëmtuar asnjë nga ta. "Askush nga dëshmitarët e thirrur si të dëmtuar nuk janë dëmtuar nga vendosja e njehsorëve elektrikë", konstatohet në vendim. KEDS-i e ka mirëpritur vendimin e Gjykatës së Apelit, duke theksuar se në këtë rast u vendos drejtësia.



## ATK-ja ka nisur revokimin e licencave të lojërave të fatit



PRISHTINË, 2 MAJ (ER) - Duke marrë parasysh se më 10 maj 2019 hyn në fuqi Ligji Nr. 06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar të gjithë opinionin dhe subjektet ekonomike, se me qëllim të zbatimit të dispozitave ligjore, sipas nenit 1 të Ligjit Nr. 06/L-155, i cili kërkon ndalimin dhe mbylljen e të gjitha lojërave të fatit në

Republikën e Kosovës, ka filluar revokimin e të gjitha licencave të subjekteve që merren me organizimin e Lojërave të Fatit. "Ky revokim i licencave hynë në fuqi nga data 10 maj 2019 dhe çdo ushtrim i aktivitetit të lojërave të fatit pas kësaj date do të konsiderohet aktivitet i kundërligjshëm, kështu që institucionet e zbatimit të ligjit do të veprojnë sipas detyrës zyrtare.

Administrata Tatimore e Kosovës i inkurajon të gjitha subjektet ekonomike dhe qytetaret që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura në respektim të dispozitave të Ligjit të ri Nr. 06/L-155, për Ndalimin e Lojërave të Fatit, pa pasur nevojë që të bëhen subjekt i masave të institucioneve të shtetit që janë përgjegjëse për zbatimin e ligjit", është thënë në njoftimin e ATK-së.

## Kryeshefi i Telekomit u ndan mirënjohje punëtorëve të dalluar

PRISHTINË, 2 MAJ (ER) - Kryeshefi i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, ka ndarë të enjten mirënjohje për 22 punëtorë të dalluar për punën e tyre të palodhshme dhe intensive si dhe për angazhimin e madh me orar të zgjatur të punës për krijimin e hapësirave të reja dhe moderne në Telekomin e Kosovës. "Puna dhe përkushtimi i tyre dhe i shumë kolegëve tanë anekënd Kosovës është

motivi ynë shtesë që ta vazhdojmë realizimin e strategjisë sonë për zhvillimin e Telekomit të Kosovës, njëherësh të vazhdojmë t'i inkurajojmë dhe nxisim të gjithë punonjësit e kompanisë sonë që të punojnë me përkushtim, meqë praktika e tillë e ndarjes së mirënjohjeve, por edhe shpërblimeve për punonjësit e dalluar, do të vazhdojë edhe në të ardhmen", ka thënë Istrefi.



## USAID-i mbështet fermerët, synohet rritja e prodhimit të asparugjve

PRISHTINË, 2 MAJ (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Dijana Ziviq, ka marrë pjesë në Panairin "Ditët e Promovimit të Asparagut", i cili është organizuar nga MBPZHR-ja dhe programi i USAID-it Zhvillimi Bujqësor dhe Mundësitë Rurale (AGRO). Drejtori i Zyrës Ekonomike në USAID, Brian Martalus, ka thënë se në Kosovë nevoja për prodhimin e asparugjve është më e madhe, prandaj edhe USAID-i po ndihmon në kultivimin e kësaj bime. Ai ka deklaruar se USAID-i po ndihmon që të promovohen asparugjt sepse janë edhe të shëndetshëm, edhe është një bimë shumëvjeçare. Ditët e promovimit të asparagut kanë filluar të enjten dhe do të zgjasin deri më 4 maj, ndërkaq asparagu është një bimë barishtore e cila në Kosovë kultivohet kryesisht në Pejë, Obiliq, Vushtrri, Mitrovicë, Lipjan, Istog, Prishtinë dhe Kamenicë.



## Asnjë hidrocentral në Kosovë nuk ka leje mjedisore

PRISHTINË, 2 MAJ (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, gjatë raportimit para

Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, ka bërë me dije të enjten se asnjë hidro-

central në Kosovë nuk ka leje mjedisore dhe se deri më tani vetëm një kërkesë ka pasur për leje mjedisore. Matoshi ka folur

edhe rreth vendosjes së laurës në Grykën e Rugovës, të cilën janë duke e kundërshtuar banorët.





## Shpërndahen lodra për fëmijët e Qendrës së Autizmit në Podujevë

PODUJEVË, 2 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Agim Veliu, bashkë me pjesëtarët e kontingjentit amerikan të KFOR-it dhe të Policisë Kufitare të Kosovës, kanë

shpërndarë të enjten lodra për fëmijët e Qendrës së Autizmit në Podujevë.

Veliu ka thënë se lodra të tilla janë shpërndarë edhe për fëmijët me nevoja të veçanta

në Shkollën "Kongresi i Manastirit" në Gllamnik dhe për disa fëmijë të komuniteteve pakicë. Lodrat janë dhuratë nga KFOR-i amerikan.

## Sejdi Hoxha zyrtarizon kandidaturën për kryetar të Degës së PDK-së në Drenas

DRENAS, 2 MAJ (ER) - Sejdi Hoxha ka zyrtarizuar kandidaturën për kryetar të Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Drenas. Ai përmes një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka treguar arsyet e kandidimit për kryetar të Degës së PDK-së në Drenas. "Duke qenë së bashku me ju gjatë tërë procesit zgjedhor, kam parë një garë të ndershme, masive, kulturore të lartë politike dhe entuziazëm të jashtëzakonshëm për inkuadrin në strukturat e PDK-së në Drenas. Do të mbeten të paharueshme takimet dhe bisedat që kam pasur me juve anëtarë dhe simpatizantë të të gjitha nëndegëve. Tek ju e kam parë besimin e madh që keni në Partinë Demokratike të Kosovës dhe kryetarin Kadri Veseli", ka thënë Hoxha. Sejdi Hoxha ka kërkuar përkrah-



jen e anëtarëve të PDK-së. "Kërkoj përkrahjen tuaj që së bashku t'i fuqizojmë edhe më shumë strukturat tona partiake në Drenas, bastionin e pamposhtur të PDK-së. Ju garantoj se këtë pozitë do ta konsideroj përgjegjësi shumë të lartë. Do të punoj me nder dhe sinqeritet, me secilin nga ju, drejt realizimit të projektit të madh zhvillimor Dekada e Re", ka thënë Sejdi Hoxha.

## Bahtiri dhe përfaqësuesit e KDI-së bisedojnë për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje



MITROVICË, 2 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të enjten në takim përfaqësuesit nga Instituti Demokratik i Kosovës, Ahmet Rushiti, Krenare Loxha dhe Arjeta Miftari. Në këtë takim u diskutua për mundësitë e rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje në kuadër të projektit të KDI-së "Rritja e llogaridhënies së institucioneve lokale", i cili mbështetet nga Ambasada e Britanisë.

Përfaqësuesi nga KDI-ja, Ahmet Rushiti, ka thënë se qëllimi i këtij projekti është përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje në Komunën e Mitrovicës, e cila deri më tani ka treguar një transparencë të lartë, mirëpo synimi i këtij projekti është edhe rritja e llogaridhënies nëpër institucionet lokale. Me këtë rast, kryetari Bahtiri ka thënë se është i interesuar që qytetarët të përfshihen në vendimmarrje pasi, sipas tij, transparencën është prioritet për të. "Si

qeverisje jemi të interesuar që vendimet për secilin fshat/lokalitet t'i konsultojmë paraprakisht me qytetarët dhe për këtë kërkoj bashkëpunimin tuaj", ka thënë Bahtiri.

Po ashtu, kryetari Bahtiri ka ofruar mbështetjen e plotë për realizimin e këtij projekti në Komunën e Mitrovicës, duke theksuar se ai dhe ekzekutivi janë të përkushtuar për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha institucionet komunale.

## Komuna e Prizrenit shpall konkurs publik: Shtëpi e pastër, qytet i pastër

PRIZREN, 2 MAJ (ER) - Drejtorja e Shërbimeve Publike në kuadër të Sektorit të Mjedisit në Komunën e Prizrenit ka shpallur konkurs publik për përzgjedhjen e: Ballkonit më të bukur me lule; Kopshtit më të rregulluar; Rrugës më ekologjike dhe Lagjes më të pastër. "Ftohen qytetarët që kanë kopshte, ballkone të bukura, përfaqësues të lagjeve dhe rrugëve, të

konkurrojnë në Sektorin e Mjedisit, që të bëhen pjesë e përzgjedhjes. Aplikimi në këtë konkurs bëhet nëpërmjet Qendrës së Thirrjeve (Numri +383 45 119 200 në Viber dhe WhatsApp), ku aplikuesit së bashku me 2-3 fotografi duhet t'i dërgojnë edhe informatat personale si emri dhe mbiemri dhe adresa e saktë. Aplikimi mund të

bëhet edhe me kërkesë me shkrim në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, përkatësisht në Sektorin e Mjedisit", është thënë në njoftimin e Komunës së Prizrenit. Fituesit e këtij konkursi do të shpërblehen me shumë dhurata që korrespondojnë me natyrën e konkursit. Konkursi mbetet i hapur nga data 1 maj deri më 31 maj 2019.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE  
Drejtoriajtë Za shërbime Publike / Komuna Prizrenit / Prizreni

Sektorit të Mjedisit shpall

### Konkurs Publik

KOMUNA E PRIZRENIT  
Opština Prizren / Prizren Belediyesi

**Ballkoni**  
Më i bukur me lule

**Kopshti**  
Më i rregulluar

**Rruga**  
Më ekologjike

**Lagjja**  
Më e pastër

Konkursi është i hapur deri më  
**31.05**

## Kryetari Latifi pret në takim qytetarët

RAHOVEC, 2 MAJ (ER) - Çdo të enjte kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, pret në takim një numër të madh të qytetarëve, të

cilët i shprehin kërkesat e tyre në prani të kryetarit. Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka shpre-

hur vullnetin dhe gatishmërinë e tij për t'i përmbushur kërkesat që kontribuojnë për rritjen e mirëqenies së qytetarëve të

Rahovecit. Latifi ka bërë me dije se takime të ngjashme me qytetarë do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.



## 8. Struktura sociale dhe politike e bartësve të ngjarjeve të vitit 1981



**Prof. ass. dr. Sabri  
KIQMARI**

Ministri i Brendshëm i Jugosllavisë, Stane Dolanc, pas demonstratave të studentëve të Universitetit të Prishtinës në mars dhe prill të vitit 1981, pati deklaruar se ato janë organizuar nga "grupet profashiste... me qendër në Stuttgart, Bruksel dhe vende të tjera në Evropë" (Meier 1995: 48). Edhe disa udhëheqës komunistë të Kosovës, të cilët konsideroheshin si "përkrahës të etur të linjës jugosllave", do të deklaroronin se demonstratat e vitit 1981 janë organizuar nga "grupe nacionaliste, irredentiste, separatiste, antirevolucionare etj.". (Meier 1995: 59). Një përshkrim të këtyre akuzave të udhëheqjes komuniste kosovare dhe jugosllave e ka bërë historiani britanik Noel Malcolm. Ai dekonstrukturon me shumë kujdes "procesin e diferencimit ideopolitik" dhe kualifikimin e demonstratave si "kundërrevolucionare, shoviniste dhe separatiste" (Malcolm 2011: 422).

Por, ndryshe nga udhëheqësit e Lidhjes Komuniste, Ukshin Hoti ka një meritë të jashtëzakonshme në përshkrimin e strukturës sociale të bartësve të demonstratave të vitit 1981. Ai shkruan se sipas të dhënave statistikore mbi përkatësinë profesionale, të gjinisë, të origjinës sociale, të moshës, "pjesa më e madhe e tyre ishin të rinj, nxënës, me shkollë të mesme të kryera, ose studentë e të rinj të tjerë me diplomë fakulteti, shumica të papunë, por edhe të punësuar... Shumica absolute kishte prejardhje fshatare, por kishte edhe punëtorë, si dhe të shtresave të tjera shoqërore, por më pak" (Hoti 1995: 67).

Racionalizmi politik i Ukshin Hotit nuk i përket vetëm rrafshit teorik, por edhe veprimit praktik. Ai është profesor, që nuk është vetëm pranë studentëve, por me studentët, që i kupton dhe i mbron ata politikisht e moralisht: "Ata nuk ishin kontrarevolucionarë e as të manipuluar", shkruan ai. Ukshin Hoti e pranon se të rinjtë demonstrues të vitit 1981 e kishin gjetur në literaturën politike shqiptare fundamentin e tyre për t'u artikuluar me shkrim, në formë të programeve, pamfleteve, parullave e shkrimeve të tjera. Por ai konstaton me të drejtë, se ky nuk mund të ishte indikacion i përcaktimit të tyre të pjekur ideologjik. Ata të rinj të moshës 18-24 vjeçare, që i kishte takuar nëpër burgje, por edhe jashtë tyre, "nuk mund të kishin qenë, edhe po të kishin dëshiruar, njohës të thelluar të sistemeve komplekse të mendimit dhe se andaj, politika e dënimeve të tyre të rënda nuk kishte qenë me vend" (Hoti 1995: 18). Hoti

ishite i bindur se të rinjtë demonstrues të vitit 1981 nuk mund të ishin armiq, nacionalistë, irredentistë e kundërrevolucionarë, siç do të kualifikoheshin nga Lidhja Komuniste e Jugosllavisë dhe, për fat të keq, edhe nga Lidhja Komuniste e Kosovës. Ky kualifikim ishte përdorur për të zgjeruar dhunën mbi shqiptarët në Kosovë, e cila do të arrinte kuota marramendëse: gjer në vitin 1989 ishin trajtuar nga policia rreth 584.373 veta, që përafërsisht do të thoshte çdo i katërti shqiptar. Me këtë Lidhja Komuniste e Kosovës (dhe LKJ) "kishin krijuar dy botë totalisht të kundërvëna ndaj njëra-tjetrës" (Hoti 1995: 67).

Ukshin Hoti kishte qenë pranë studentëve gjatë demonstratave të vitit 1981. Madje në raste të caktuara ai kishte qëndruar në mes të milicisë dhe studentëve. Ai nuk mund t'i mendonte studentët e tij si armiq, irredentistë, nacionalistë e kundërrevolucionarë. Kur politika kërkon prej tij me arrogancë që të ndërhyjë për të ndaluar demonstratën, ai kishte vendosur të rreshtohet me studentët kundër politikës së Lidhjes Komuniste. Me këtë akt ai do të shndërrohej në simbol të intelektualit të guximshëm, që e sakrifikon veten për të ardhmen, për të mirën, për të drejtën.

Hoti i përshkruan të rinjtë demonstrues, bashkë me të cilët do të kalonte vite të tëra burgu, si të rinj të etur për dije nga fusha e shoqërisë, politikës, filozofisë, historisë, antropologjisë, që lexojnë me zell dhe mbajnë shënime ilegalisht, kanë etje përvëluese për të mësuar për veten dhe për shoqërinë që i kishte dënuar. Ata ishin të brumosur me një botë ideale, një botë të pastër, të mirë, botë barazie e humane: "Këta të rinj e kishin pasur shpirtin e pastër, të çiltër si rezja e diellit në mëngjes. As në zemër dhe as në mendje nuk e bartnin të keqen. Ideali i tyre dukej sinonim me të mirën dhe të bukurën. Bota që e gjakonin ishte e përmbushur me shpirtin e tyre të pastër, me ëndrrat e tyre të bukura, me idealat e tyre të mëdha. Ishte ajo një botë e barazisë së përgjithshme dhe të plotë, e zhveshur nga ligësitë e llojeve të ndryshme. E dëshironin një botë me raporte të çiltra e humane, me konkurrencë të lirë të mendimit dhe të ideve, me kritere të njëjta të zgjedhjes së më të mirit, pa përbuzje, një botë ku do të shpërthenin vlerat e tyre të njëmendta individuale dhe gjeniu i tyre kolektiv krijues" (Hoti 1995: 72). Dhe profesori i tyre, Ukshin Hoti, e përjeton botën e tyre me ta dhe i gëzohet pranishë së tij mes tyre: "Unë, i shkolluari në metropolet e vendit dhe të botës, ndonëse i katandisur rëndë në burg, gëzohesha kur më konsideronin të vetin" (Hoti 1995: 72).

Mbrojtja e të burgosurve politikë nga ana e Ukshin Hotit vazhdon edhe pas krijimit të partive politike në Kosovë. Ai e kritikon ashpër LDK-në, e cila në hapat e saj të parë të veprimit kishte si synim "përfundimin e tyre nga jeta shoqërore me metodën e vjetër të etiketimit më

parë si irredentist e nacionalist, kurse tani si 'të kuqë', 'komunistë' e 'marksistë-leninistë'" (Hoti 1995: 15). Ai ironizon me të drejtë se prapa këtij sistemi të të menduarit fshihen interesa meskine dhe tentimi që të vazhdohet e djeshmja nën vallon e demokracisë: "Komunistët e dikurshëm të sistemit i etiketojnë bartësit e njëmendtë të demokracisë, ata që i kontribuuan fuqimisht lindjes së saj, dhe ua mohojnë të drejtën e pjesëmarrjes në jetën shoqërore të demokracisë, me pretekstin e 'majtizmit' të tyre" (Hoti 1995: 15). Në këto fjali zhvishet morali i një strukture dhe sistemi të të menduarit, i cili përshtatjen me vlerat e reja për vete, mundohet t'ua mohojë të tjerëve, duke harruar se vetë kishte qenë aktive dhe agresive kundër tyre edhe në të kaluarën.

### 9. Dështimi i elitës politike dhe heshtja e intelektualëve

Ukshin Hoti e kritikon mosangazhimin e inteligjencës universitare dhe elitës politike në demonstratat e vitit 1981. Shumica e shtresës intelektuale në Kosovë pas vitit 1981 mbyllet në vete dhe hesht (Qosja 2014: 442). Mendohej se heshtja e saj flet vetë. Heshtja ishte mënyrë për të shmangur burgun. Hoti është mjaft kritik ndaj intelektualëve. Sipas tij shtresa intelektuale "nuk kishte dashur të humbte asgjë: as besimin e masave dhe as pozitën e vet shoqërore" (Hoti 1995: 71).

Heshtjen e intelektualëve të Kosovës ishte munduar ta thyejë Lidhja Komuniste përmes procesit të diferencimit ideopolitik. Dhe, kishte arritur të detyronte shumë prej intelektualëve të bënin akte të deklarimit formal kundër demonstratave të vitit 1981. Ata që nuk kishin bërë deklarime të qarta ishin sanksionuar, kurse ata që ishin regjistruar më të vendosur ishin përjashtuar nga Lidhja Komuniste e Kosovës dhe Universiteti. Heshtja e intelektualëve do t'i lëndonte shumë studentët demonstrues. Në rrethana të tilla, studentët do ta orientonin vëmendjen drejt Shqipërisë, të cilën, siç konstaton Hoti, do ta përjetonin si një lloj mbështetjeje në raport me heshtjen në Kosovë (Hoti 1995: 71).

Ukshin Hoti përmes një metode sintetike bën një dekonstruktiv të jashtëzakonshëm të rezonimit të titistëve, të kthyer brenda natës në demokratë, pas ndryshimeve sistemore në vitin 1990. Ai shkruan se ata ishin të pajisur me një psikologji tipike antidemokratike. Mendimet e kundërshtarëve e etiketojnë si stalinistë dhe "serbo-sllavo-komuniste". Pra, titistët gjuajnë në ambientin publik shqiptar "shtrigastaliniste" në hapësirën "edhe ashtu të ngushtuar politike të Kosovës": "T'i akuzosh ata që e lindën edhe Republikën edhe demokracinë se nuk e deshën këtë të fundit, do të thotë se diç nuk është në rregull, jo vetëm në kokat e individëve, por në raportet në shoqëri" (Hoti 1995: 89).

Hoti në analizat e tij në lidhje me elitën titiste është shumë i drejtpërdrejtë. Ai shkruan se elita titiste nuk ka qenë në gjendje të kuptojë ato që po ndodhnin në Kosovë, vazhdimisht ka qenë e befaluar nga ngjarjet dhe në bisht të tyre, ishte e frikësuar, e paafte. Ajo u bë me popullin, vetëm kur u shndërrua vetë në subjekt eliminimi të partisë së tyre, Lidhjes Komuniste. Por, edhe pas kësaj, elita titiste e keqpërdori futjen në vallon e demokracisë. Ajo "nuk e kuptoi atë si pjesëmarrje të barabartë në luftën për demokraci dhe për Republikën e Kosovës, por si mision për eliminimin e atyre të mëparshmeve" (Hoti 1995: 89).

Elita titiste në Kosovë nuk mund të emancipohej nga pushteti i vjetër, nuk mund të mendonte me kokën e vet. E paafte për veprim strategjik politik, ajo kërkonte mbështetje nga jashtë, nëse jo në Beograd, atëherë doemos në Evropë. Pra, vëmendjen e përqendroi sërish te faktori i jashtëm.

Në librin e tij "Filozofia politike e çështjes shqiptare", Hoti paraqet një këndvështrim të jashtëzakonshëm sociologjik në lidhje me rrjetet e ndikimit politik nga qyteti në fshatrat e Kosovës. Ai e përshkruan këtë si "fenomenin e bijve të 'tatave' në Prishtinë, të cilët mbështeteshin nga bijtë e 'haxhi-babave' në fshat" (Hoti 1995: 98).

Elita politike si në kohën e LKJ, edhe pas vitit 1990, kërkon kuadro luajalë për vete dhe jo për zhvillimin e Kosovës. Zhvillohet një luftë e mëhalla për të instaluar kandidatin e vet, pavarësisht aftësive. Djemtë me aftësi të veçanta izolohen nga mëhalla e vet. Shumica e të zgjedhurve ishin njerëz që jetojnë nëpër familje të mëdha, të cilët nuk e kishin provuar ndonjëherë shpërndarjen dhe jetën individuale, "të cilët ndonëse qytetarë akademikë, i nënshtroheshin jo vetëm autoritetit, por edhe gjykimave të më të vjetërve dhe të zotit të shtëpisë" (Hoti 1995: 99).

Dhe, familjet e tilla krijonin lidhje me shtresën intelektuale në Prishtinë, e cila gjithashtu në thelb udhëhiqej me leverdinë materiale. Përfaqësues të veçantë të shtresës intelektuale i vizitonin familjet e tilla në fshat me pretekste të ndryshme, "rëndon kinse për t'i takuar ish-studentët e tyre, të cilëve edhe ashtu shpesh ua kishin falur notat, po në të vërtetë për t'i mbushur gepekët e veturave të tyre të mëdha me zarzavate e gjëra të rastit" (Hoti 1995: 100). Hoti konstaton se në këtë mënyrë ishte krijuar një shoqëri çuditërisht njëtrajtëshe në themelin e së cilës ndodhej një oportunitet i tmerrshëm, jo vetëm ndaj kërkesave të kohës, por edhe ndaj kërkesave të jetës në përgjithësi" (Hoti 1995: 100).

Një raport i tillë, i përshkruar më lart, e mohonte pothuajse totalisht rolin e femrës si subjekt shoqëror, oda shndërrohej në simbol të rendit shoqëror dhe në këtë mënyrë konservohej gjendja ekzistuese. Simbioza e tillë oportuniste "nuk e lejonte zgjedhjen e më të mirëve në strukturat udhëheqëse, jo vetëm të


LDK-së" (Hoti 1995: 100). Ai do të prekej shumë nga kjo gjendje dhe do të konstatonte në Kuvendin e Krushës se "në Evropë nuk mund të shkohet me raporte feudo-klanore e feudo-kapitaliste" (Hoti 1999: 100). Dhe kishte ofruar dorëheqjen, gjë që do të bënte që salla të ngrihej në këmbë dhe masa kërcënonte të shpërthejë në mbështetje të tij.

### 10. Demokracia autentike

Duke cituar George Orwell-in nga libri i tij "1984", Ukshin Hoti e dekonstrukturon në thelb logjikën e sistemeve totalitare: "Pushteti nuk është mjet, ai është qëllim. Njeriu nuk vendos diktaturën për ruajtjen e revolucionit; Revolucioni bëhet për vënien e diktaturës. Qëllimi i torturës është tortura. Qëllimi i pushtetit është pushteti" (Hoti 1995: 92).

Përmes shkrimeve të tij, pas daljes nga burgu, Ukshin Hoti do ta njohim, në njërën anë, si një kundërshtar të pakompromis të logjikës totalitare dhe, në të njëjtën kohë, si një ithtar të mirëfilltë të demokracisë, nëse me demokraci e nënkuptojmë formën e qeverisjes, rendin politik dhe sistemin politik, në të cilin pushteti dhe qeverisja burojnë prej vetë popullit. Bazuar në këtë ide shkencore për demokracinë, Ukshin Hoti e preferon për Kosovën një demokraci të llojit të veçantë - një demokraci autentike, pra një lloj sistemi shtetëror dhe shoqëror, në të cilin pushteti dhe qeverisja burojnë prej vetë popullit të Kosovës. Ai nuk pajtohet me një demokraci të imponuar nga jashtë. Sipas tij, demokracia nuk i duhet Kosovës "për t'u stolitur (se edhe ashtu është e bukur), e as për të vallëzuar me të" (Hoti 1995: 59).

Kosova mund të arrijë në Evropë vetëm me një demokraci autentike, të vetëlindur prej saj (Hoti 1995: 87). Dhe ai do të konstatonte se demokracia në Kosovë është vetëlindur më 27 janar 1990 në fshatin Brestovë (4 të vjetër dhe 19 të plagosur) dhe në ditët "e mëpastajme në Kosovë, të mbushura me gazra kimike, tym e barot dhe viktimat të reja në njerëz" (Hoti 1995: 216). Me këtë shqiptarët e kanë paguar tagrën e gjakut për idealin e Republikës dhe Demokracisë, "në zbatimin e parimeve universale, të gjithëpranueshme të demokracisë, por edhe në ndërtimin dhe përsosjen e saj të vazhdueshme si ide universale e orientimit të njeriut për të jetuar i lirë dhe i barabartë me të tjerë". (Hoti 1995: 218). (Vijon)





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



# AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:**

**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**



## BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Nafi Berisha shpall te pavlefshme deftesen e vitit I shmlt "11 Marsi " Prizren
- ▶ Sadan Pervance shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shf " Motrat Qiriazii " Prizren
- ▶ Albina Krasniqi shpall te pavlefshme deftesat e kl VI - IX shf " Leke Dugagjini " Prizren
- ▶ Afrim Seferqaj shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shf " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit
- ▶ Anesa Besimi shpall te pavlefshme deftesat e kl I - V shf " Emin Duraku " Prizren
- ▶ Rufat Etemi shpall te pavlefshme deftesen e vitit I shmlt "11 Marsi " Prizren
- ▶ Arben Tertini shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shf " Fadil Hisari " Prizren
- ▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irro 044/672-439.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

## Trumpi: Dhuna në Venezuelë duhet të ndalet menjëherë

WASHINGTON, 2 MAJ - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, bëri thirrje të enjten që t'i jepet fund represionit brutal në Venezuelë ku presidenti Nicolas Maduro i ka bërë thirrje ushtrisë që t'i luftojë puçistët një ditë pas manifestimeve të reja kundër atij. "Represioni brutal kundër

popullit venezuelas duhet të përfundojë, duhet të përfundojë menjëherë", theksoi Trumpi që nga Shtëpia e Bardhë. "Njerëzit kanë uri. Ata nuk kanë ushqime, ata nuk kanë ujë në atë që ishte një prej vendeve më të pasura në botë", tha tutje presidenti amerikan. ShBA-ja, që e njeh opozitarin Juan Guaido si president të

përkohshëm, ka zbatuar sanksione ekonomike për të detyruar Nicolas Maduro të dorëhiqet.

Thirrja e Trumpit erdhi pasi ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov dhe Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, ranë dakord të takohen javën e ardhshme për të diskutuar situatën në Venezuelë.



# Fillon fushata për zgjedhjet vendimtare të Parlamentit Evropian

Në këto zgjedhje po ofrohen dy vizione të Evropës që bien ndesh me njëra-tjetrën, me centristët që udhëhiqen nga presidenti francez, Emmanuel Macron dhe populistët nacionalistë, me në krye udhëheqësin e së djathtës së skajshme të Italisë, Matteo Salvini

BRUKSEL, 2 MAJ - Partitë politike në gjithë Evropën kanë nisur fushatën për, ndoshta, zgjedhjet më të rëndësishme të Bashkimit Evropian që nga viti 1979, kur qytetarët e bllokut filluan të votojnë për Parlamentin Evropian.

Pjesëmarrja është normalisht e ulët në 28 vendet anëtare, mesatarisht 43 për qind, por partitë e reja populiste dhe nacionaliste të kontinentit shpresojnë që ky vit të jetë i ndryshëm. Votimet janë parashikuar të mbahen nga 23 deri më 26 maj.

Udhëheqësit e tyre besojnë se pjesëmarrja e lartë do të jetë në avantazh të tyre, ndërsa përpunohen ta frenojnë integrimin evropian dhe t'i rikthehen një kohe kur, sipas ideologjisë së tyre, shtetet nuk e ndanin sovranitetin me fqinjët.

Sipas një ankete në Evropë, dy të tretat e të gjithë evropianëve dhe tre të katërtat e gjermanëve kanë

ndër mend të votojnë në zgjedhje. Për populistët, mirëqenia ekonomike po bëhet dytësore ndaj identitetit kombëtar dhe mesazhi i tyre i ka rrënjët në ndjenjat anti-imigracion.

Partitë tradicionale të Evropës që ndjekin kryesisht një politikë socio-ekonomike, mund të pësojnë humbje në zgjedhjet parlamentare të këtij muaji nën sfidën e partive populiste, që mbështeten në ndasitë socio-kulturore. Sipas anketave, mbështetja për populistët po rritet.

Në këto zgjedhje po ofrohen dy vizione të Evropës që bien ndesh me njëra-tjetrën, me centristët që udhëhiqen nga presidenti francez, Emmanuel Macron dhe populistët nacionalistë, me në krye udhëheqësin e së djathtës së skajshme të Italisë, Matteo Salvini. Populistët po këshillohen nga ish-ndihmësi i presidentit Donald Trump, Steve Bannon.



Presidenti francez Macron po e paraqet veten si antidota e së ashtuquajturave "demokrati joliberal" të Evropës Qendrore dhe mbrojtës i Bashkimit Evropian. Udhëheqësi francez do që të reformojë dhe rigjallërojë bllokun, duke thelluar integrimin politik dhe ekonomik të Evropës.

44 vjeçi Salvini jo vetëm që do të frenojë imigracionin e mëtejshëm, por do të ndër marrë një

zmbarsje, në mënyrë që blloku të bëhet më shumë një grup vendesh jo aq të lidhura dhe me më pak të kufizuara nga Brukseli dhe traktatet e BE-së. "Ne po punojmë për një ëndërr të evropiane", tha Salvini në mars, në një grumbullim udhëheqësish populistë evropianë.

Ai do që populistët të paraqesin një platformë të përbashkët elektorale, të ngjashme me manifestin e partisë së tij, Lega që

angazhohet "të theksojë dhe rikonfirmojë rrënjët e përbashkëta të krishtera, të mbrojtë identitetin kombëtar dhe përparësinë e ligjeve dhe direktivave të vendit ndaj atyre evropiane".

Partitë populiste, veçanërisht në Itali, Poloni, Hungari dhe Francë, pritet të fitojnë terren të konsiderueshëm, në zgjedhjet e majit për Parlamentin me 750 vende.

## Prokurori i Përgjithshëm Barr nuk paraqitet në Komisionin e Kongresit

Uashington, 2 maj - Kryetari i Komisionit juridik të Dhomës së Përfaqësuesve, Jarrold Nadler tha se "momenti i përgjegjës" për Prokurorin e Përgjithshëm William Barr do të vijë së shpejti, pasi ai refuzoi t'i respektojë kërkesat mbi raportin e Prokurorit të Posaçëm lidhur me hetimin për ndërhyrjen ruse në zgjedhjet presidenciale të vitit

2016.

Barr nuk u paraqit në këtë komision të enjten, pasi Departamenti i Drejtësisë ishte kundër një lëvizjeje për të lejuar juristët në personelin e komisionit që të merren pjesë për t'i drejtuar atij pyetje.

Departamenti i Drejtësisë gjithashtu nuk respektoi një afat për t'i dhënë komisionit raportin

e plotë, të përdiktuar të Prokurorit të Posaçëm, Robert Mueller.

Demokrati Nadler, tha në seancën që zgjati vetëm 20 minuta se Barr nuk i kishte bërë "qëndresë presidentit" dhe të trajtonte çështjen e "këtij rreziku të qartë ndaj rendit tonë kushtetues".

Nënkryetari republikan i komi-

sionit, Doug Collins, tha se "demokratët nuk e donin Barr në seancë sot" dhe shtoi se "loja dhe cirku vazhdojnë këtu".

Pak pas seancës, kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve Nancy Pelosi e akuzoi Barr se kishte gënjer Kongresin kur dëshmoi më 9 prill se nuk ishte në dijeni të shqetësimeve të Mueller për mënyrën se si i kishte paraqitur

publikisht përfundimet e prokurorit të posaçëm.

Departamenti i Drejtësisë bëri të mërkurën publike një letër të Mueller drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm Barr që pasqyron shqetësimet e Mueller para seancës së 9 prillit. "Ai gënjeu Kongresin. Nëse do ta kishte bërë një gjë të tillë dikush tjetër, do të konsiderohej krim", tha Pelosi.

## Në Izrael fillon Dita e Përkujtimit të Holokaustit

TEL-AVIV, 2 MAJ - Izraeli ka filluar periudhën 24 orëshe që shënon Ditën e Përkujtimit të Holokaustit, duke nderuar 6 milion hebrenjtë e vrarë nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Përkujtimi filloi në perëndim të diellit më 1 maj, me ceremoninë kryesore të përkujtimit në Qendrën Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit "Yad

Vashem" në Jerusalem.

Përkujtimet e këtij viti organizohen pas sulmeve fetare në rritje në mbarë botën, duke përfshirë edhe të shtënat në një sinagogë në Kaliforni më 27 prill, ku u vra një person dhe u plagosën tre të tjerë.

Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka thënë se të shtënat në sinagogën e Kalifornisë

sërish na sjellin në vëmendje rritjen e antisemitizmit.

Presidenti i Izraelit, Reuven Rivlin, ka paralajmëruar për rritjen e antisemitizmit në Evropë duke thënë se "antisemitizmi edhe një herë po ngre kokën duke nxitur valë emigrimi".

Në Ditën e Përkujtimit të Holokaustit në Izrael kafenetë



kanë qenë të mbyllura dhe stacionet radio-televizive

jetuar në Evropë është vrarë gjatë kësaj kohe.

Bisedë me Milan Kunderën

# KULTURËS I DUHEN KUFIJTË E HAPUR (2)

**Bisedoi: Olga CARLISLE**

**Olga Carlisle:** *Thuhet nganjëherë se, paradoksalisht, shtypja i jep më shumë seriozitet dhe gjallëri artit dhe letërsisë.*

**Milan Kundera:** Të mos bëhemi romantikë. Kur represioni zgjat shumë mund ta shkatërrojë krejtësisht një kulturë. Kulturës i duhet jeta publike, këmbimi i lirë i ideve; i duhen botimet, ekspozitat, debatet dhe kufijtë e hapur. Prapëseprapë, për njëfarë kohe, kultura mund të mbijetojë në rrethana jashtëzakonisht të vështira.

Pas pushtimit rus më 1968 ishte ndaluar pothuajse krejt letërsia çeke dhe qarkullonte vetëm në dorëshkrim. Ishte shkatërruar jeta kulturore publike. Megjithatë, letërsia çeke e viteve shtatëdhjetë ishte e mrekullueshme. Proza e Hrabalit, Grusës, Skvorcekyt. Dhe atëherë, në kohën më të rrezikshme të ekzistencës së saj, letërsia çeke rroku vëmendjen dhe fitoi reputacionin ndërkombëtar. Por, sa mund të mbijetojë në nëntokë? Kurrkush s'e di. Evropa kurrë nuk ka përjetuar situata të ngjashme më parë.

Kur vjen puna te fatqësia e kombeve nuk duhet ta harrojmë dimensionin e kohës. Në një shtat fashist, diktatorial, gjithkush e di se një ditë do të marrë fund. Gjithkush sheh fundin e tunelit. Në perandorinë e lindjes tuneli është i pafund. Pa fund, së paku, nga pika e vështrimit të jetës njerëzore. Andaj, nuk më pëlqen kur njerëzit e krahasojnë Poloninë, le të themi, me Kilin. Po, tortura, vuajtja, janë të njëjta. Por tunelet janë të gjatësive krejt të ndryshme. Dhe kjo ndryshon gjithçka.

Represioni politik përbën një tjetër rrezik, i cili - posaçërisht për novelën - është edhe më i keq se censura dhe policia. E kam fjalën për moralizmin. Represioni krijon kufij të prerë ndërmjet të mirës dhe të keqes, dhe shkrimtari shumë lehtë i dorëzohet joshjes së predikimit. Prej pikëpamjes njerëzore, kjo mund të jetë çështje e thirrjes së sinqertë, por për letërsinë është vdekjeprurëse. Herman Broch, novelist austriak, të cilin e dua më fort se të tjerët, ka thënë: "Moral i vetëm për shkrimtarin është dijenia".


Vetëm një vepër letrare që sjell në dritë një fragment të panjohur të ekzistencës njerëzore arsyeton veten. Të qenët shkrimtar nuk do të thotë të predikosh një të vërtetë; nënkupton vënien në pah të një të vërtete.

**Olga Carlisle:** *Por a nuk është e mundshme që shoqëritë që përjetojnë shtypjen ofrojnë më shumë mundësi për shkrimtarin për ta vënë në dritë "fragmentin e panjohur të ekzistencës" se ato që bëjnë jetë paqësore?*

**Milan Kundera:** Mbase. Nëse e keni fjalën për Evropën Qendrore, çfarë laborator i jashtëzakonshëm historie! Në një periudhë prej shtatëdhjetë vjetësh ne kemi jetuar kohën e rënies së një perandorie, rilindjen e shteteve të vogla, demokracinë, fashizmin, pushtimin gjerman me masakrat e tij, pushtimin rus me dëbimet e tij, shpresën e socializmit, terrorin stalinist, emigrimin... gjithnjë jam shtangur prej njerëzve përreth meje që ishin mbajtur edhe në këso situata. Njeriu është bërë enigmatik. Ai mbahet si dilemë. Dhe është përtej mahnitjes se pasioni për të shkruar novelë ka lindur prej tij. Skepticizmi im në lidhje me vlera të caktuara që janë pothuajse krejtësisht të pakundërshtueshme është rrënjësor në përvojën time në Evropën Qendrore.

Ta zëmë, rinisë zakonisht nuk i referohemi si fazë, por si vlerë në vetvete. Kur e thonë këtë fjalë, politikanët gjithnjë kanë çehre teveqelësh. Por unë, kur isha i ri, jetova një periudhë terrori. Dhe ishte rinia që mbështeste terrorin, madje ishte një hise e madhe e rinisë, nëpërmjet mungesës së përvojës, papjekurisë dhe moralit krejt a hiç. Më skeptikja në mesin e krejt novelave të mia është "Jeta është tjetërkund". Tema të saj janë rinia dhe poezia. Aventura e poezisë gjatë terrorit stalinist. Qeshja e poezisë. Qeshja e përgjakshme e pafajësisë.

Poezia është edhe një prej atyre vlerave të pakundërshtueshme në shoqërinë tonë. U trondita kur, më 1950, poeti i madh komunist francez, Paul Eduard, aprovoi publikisht varjen e mikut të tij, shkrimtarit të Pragës, Zavis Kalandra. Kur Brezhnevi dërgoi tanket për t'i masakruar afganët, është gjë e tmerrshme, por është, nëse



mund të themi, normale - pritej. Kur një poet i madh lavdëron një ekzekutim, është një goditje e fuqishme që prish krejt imazhin tonë të botës.

**Olga Carlisle:** *A i bënë autobiografike veprat tuaja përvoja e madhe jetësore?*

**Milan Kundera:** Asnjëra prej novela të mia nuk është autoportretizuese, e as ndonjëri prej karaktereve të mia një person i gjallë. Nuk më pëlqejnë autobiografite e maskuara. Urrej pamaturinë e shkrimtarëve. Për mua, pamaturia, mungesa e diskretes, është mëkat i madh. Kushdo që vë në pah jetën private të dikujt tjetër meriton të fishkulohet. Po jetojmë në një epokë kur jeta private po shkatërrohet. Policia e shkatërronte jetën private në shtetet komuniste, gazetarët kërcënojnë jetën private në shtetet demokratike dhe, pak nga pak, vetë njerëzit kanë humbur shijen për jetën private dhe sensin për të.

Jeta kur njeriu nuk mund të

fshihet prej syve të të tjerëve është ferr i vërtetë. Ata që kanë jetuar në shtete totalitare e dinë më së miri, por ai sistem po sjell, si një xham zmadhues, tendencat e krejt shoqërisë moderne. Shkatërrimi i natyrës, rënia e të menduarit dhe artit, burokratizimi, depersonalizimi, mungesa e respektit para jetës personale. Pa të fshehta, pa sekrete, asgjë nuk është e mundshme, as dashuria, as miqësia.

Është bërë goxha vonë kur mbaron intervista, dhe Kundera më përcjell në këmbë deri në hotel, në një shëtitje tipike në natën parisiane. Një ose dy ditë më vonë, Kunderat më ftojnë në drekë me salcë shëlinjash të zier në stilin çek. Kundera është tekanjosh dhe zemërgjerë. Thotë se po lexon gjithnjë e më pak për shkak se botuesit francezë po botojnë libra të formatit më të vogël. Nuk e merr në konsideratë mundësinë se nuk është fjala për një komplot francez dhe i

duhen syze të reja. Ai tregon bishtnimitin e shkrimtarit të vërtetë kur pyetet se çfarë fikcioni po shkruan tani. Por flet me qejf për bashkëpunimin e tij të fundit mbi "farsën metafizike" me regjisorin francez të filmit, Alain Resnais. Kundera po shkruan skenarin dhe është në kërkim të një titulli. A të jetë "Tre burra dhe dy të dashura" ose "Dy burra dhe tri të dashura"? Domosdoshmëria për pak sekrete shkon huq shërri i një lëshimi të vogël.

Ky është Milan Kundera, të cilin miqtë e vitit 1968 e kujtojnë si njeri të lumtur, Kundera i shkuar në shtet dhe i "Dashurive qesharake", të cilën e pëlqen më së shumti prej të gjitha veprave të tij, sepse është e lidhur me periudhën më të hareshme të jetës së tij.

(Marrë, pas përkthimit nga "New York Times", dhënë në maj të 1985-s, nga numri i pestë i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia", botuar këtë muaj)



E jashtëzakonshme

## Zgjohet me 200 dele në oborr të shtëpisë

Kush ka shtëpi me oborr mund t'i ndodhë shpesh t'i futen kafshë të huaja, por pak veta mund të jenë zgjuar me 200 kokë dele pa zot në oborr. Erin Ruso, në Kaliforni të ShBA-së, u zgjua një mëngjes nga blegërimat dhe kur hapi derën nuk po u besonte syve. Delet pa zot janë sjellë nga bashkia dhe janë lënë të enden nëpër zonë, me shpresën që të hanë shkurret që kanë shkaktuar zjarre shumë të rënda në territor.




FOTO E DITES



Anëtarët e Konfederatës Koreane të Sindikatave në Korenë e Jugut mbajnë parulla në duar për 1 Maj. /AP/

E rrallë

## Hapi gropë për ish-gruan nga xhelozia, për pak humbi jetën brenda



Një 50-vjeçar në Meksikë e la gruaja pas 14 vjetësh sepse ai e kishte tepruar në shumë raste me xhelozinë, aq sa ndarja përfundoi me një urdhër gjyqate që e detyronte burrin të mos i afrohej gruas

apo shtëpisë së saj, ose do të futej në burg. Gruaja vazhdoi jetën, por një ditë dëgjoji disa zhurma pranë shtëpisë. Ish burri i saj xheloz kishte hapur një gropë pranë oborrit, që ta përgjonte pa rënë në sy,

pa u prekur nga ligji. Por kishte ngecur brenda, pa mundur të lëvizte, për më shumë se 24 orë. Mjekët e gjetën në gjendje të dehidratuar dhe e dërguan menjëherë në spital.

## BARSOLETA E DITËS



Në një maternitet dy të porsalindur po bisedonin:  
 - Je djalë apo vajzë?  
 - Djalë.  
 - Ma vërteto.  
 - Sapo të shkoj infermierja do ta tregoj.  
 Sapo iku infermierja, vogëlushi tërhoqi kuvertën dhe i tha:  
 - E shikon, kam çorape të kaltra.




## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

### “HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World” 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.  
 Regjia: Dean DeBlois



Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)

### “THE KID WHO WOULD BE KING”,

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.

Regjia: Joe Cornish



Në ora 20:00

### “CAPTAIN MARVEL” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.

Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck




Në ora 22:00

### “U S”

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon

Regjia: Academy Award@-winning visionary Jordan Peele



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: **Kino ABC**.




**DASHI**

E sotmja do të jetë një ditë interesante, plot surpriza dhe ndryshime programi në çastet e fundit.



**DEMI**

Keni shumë gjëra të pazgjidhura me një koleg dhe kjo gjë do t'ju pengojë të nisni bashkë një projekt të ri dhe fitimprurës.



**BINJAKËT**

Keni lënë që persona të tjerë t'ju faturonjë probleme dhe punë të pazgjidhura. Situata ka degraduar çdo ditë e më shumë.



**GAFORRJA**

Keni lënë pas dore disa çështje të rëndësishme familjare. Nuk jeni marrë sa duhet me ato detaje që mund ta bëjnë dallimin.



**LUANI**

Sot mund të zgjidhni nga disa variante që do t'ju ofrohen. Sigurisht zgjedhja juaj do të jetë ajo më e mira dhe më e saktë.



**VIRGJËRËSHA**

Jeni shumë të mërziur sot me një person që ju ka premtuar hënën, por nuk ka mbajtur asnjë nga premtimet e veta.



**PESHORJA**

Nëse sot nuk keni vendosur se çfarë do të bëni me një projekt tuajin, është mirë të mos kërkonit zgjidhje nëse nuk keni ndarë më parë idenë.



**AKREPI**

Edhe pse ka diçka që ju shqetëson sot, jeni mësuar me këtë ndjenjë dhe mund të bashkëjetoni shumë të qetë.



**SHIGJETARI**

Mos jini shumë të bindur mbi ç'ka po bëni sot, sepse kritikë që do të merrni do të vijnë edhe nga miqtë tuaj.



**BRICJAPI**

Jeni treguar shumë të kujdesshëm me çdo person që ka kërkuar ndihmën tuaj. Mbase sot duhet të hiqni dorë dhe të merreni me veten.



**UJORI**

Sot qëndroni larg qëndrimeve të prera dhe mos jepni vendime definitive. Më vonë do të pendoheni për këtë gjë.



**PESHQIT**

Do të bëni çdo gjë me kujdes sot dhe hapat që do të hidhni do të jenë konkretë dhe mirë të argumentuar.

## Dieta, stili i jetesës dhe sekretet e Halle Berryt



**E**diagnostifikuar me diabetin e tipit '2 qysh' në moshën 19-vjeçare, Halle Berry ka qenë vazhdimisht para sfidës së madhe për ta mbajtur nën kontroll shëndetin e saj. Ajo në moshë të re e ka kuptuar se duhet të kujdeset për regjimin ushqimor dhe trupin e saj dhe këtë gjë tani duket se e bën lehtësisht. Aktore e talentuar, nënë e mrekullueshme, mike fantastike, Halle Berry është një inspirim për shumëkënd. Shpeshherë

ajo ka ndarë sekrete të vogla me fansat e saj në llogarinë e saj në "Instagram", të cilët janë hiç më pak se 3.3 milionë. Për të qëndruar në formë dhe ta menaxhojë sëmundjen e saj, ajo ushtron shumë. Berry nuk është fanse e ushtrimeve me pesha të rënda, por preferon të ushtrojë më shumë "cardio". Fokusi i saj janë muskujt e barkut. Trajneri i saj personal, Peter Lee Thomas, ka thënë se ajo ushtron tri herë në javë.



## Bebe Rexha fiton çmim në Billboard

**K**ëngëtarja shqiptare me famë botërore, Bebe Rexha, ka rrëmbyer çmim në ngjarjen e madhe muzikore Billboard Music Award. Ylli i muzikës pop mori çmimin 'Top country song' për këngën

'Meant to be' në bashkëpunim me Florida Georgia Line. Ajo ishte nominuar edhe në kategorinë "Top Radio Song", por çmimi u rrëmbye nga Cardi B dhe Maroon 5 me këngën 'Girls like you'.

## Charlize Theron thotë se është në lidhje, por jo edhe e dashuruar



**C**harlize Theron beson se mund ta gjejë dashurinë kur të vijë koha e duhur. Aktorja 43-vjeçare dhe Seth Rogen, kolegu i saj nga "Long Shot", ishin të ftuar në "The Howard Stern Show", ku Theron ka zbuluar se është në lidhje

dashurie, ndonëse më herët gjatë këtij muaji kishte thënë për "ET" se është "beqare dhe në dispozicion për lidhje dashurie". "Jam në lidhje dashurie, po. Jo, nuk jam e dashuruar. Pse është kaq e çuditshme kjo?", ka thënë Theron.

## Liam fotografohet duke darkuar me modeluesen e njohur



**N**ë fillim të muajit u kuptua se këngëtari britanik Liam Payne i kishte dhënë fund lidhjes me supermodeluesen Naomi Campbell. Dhe, me sa duket, këngëtari po kërkon tani mënyra të reja për t'i rregulluar problemet e zemrës

pasi është fotografuar duke darkuar me një modele mjaft të njohur. Bëhet fjalë për modeluesen e "Victoria's Secret", Stella Maxwell, e cila nuk ka shumë kohë që ka dalë nga një lidhje lesbike me aktoren Kristen Stewart.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
**"BUJQËSIA"**

TEL: 045 82 82 82

# Arifaj: Dukagjinit nuk i duhet barazhi për Superligë

Sulmuesi Granit Arifaj ka bërë me dije se Dukagjini i Klinës po e mendon inkuadrimit në Superligë pasi favorizohet nga pozita aktuale dhe orari në katër ndeshjet e fundit. "Para vetës kemi edhe katër ndeshje, që të gjitha janë finale për skuadrën tonë. Jemi të përgatitur maksimalisht si nga ana fizike, po ashtu edhe nga ajo psikologjike, që ta vazhdojmë rrugëtimin drejt inkuadrimit në elitë. Do ta mbajmë pozitën e dytë deri në fund dhe të inkuadrohemi drejtpërdrejt, pa pasur nevojë të luajmë në ndeshjet e barazhit", ka thënë Arifaj



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 2 MAJ** - KF Dukagjini ka bërë një hap të madh në rrugëtimin drejt inkuadrimit në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, pasi në ndeshjen fundit e ka mposhtur Istogun (2-1) dhe falë humbjes së Besës nga Ramiz Sadiku është ngritur në pozitën e dytë në renditjen tabelore. Sulmuesi Granit Arifaj ka thënë të enjten për "Epokën e re" se këtë pozitë skuadra nga Klina nuk do ta lëshojë deri në fund të kampionatit dhe inkuadrimit në elitë do të ndodhë drejtpërdrejt dhe jo nëpërmjet barazhit. "Para vetës kemi edhe katër ndeshje, që të gjitha janë finale për skuadrën tonë. Jemi të përgatitur maksimalisht si nga ana fizike, po ashtu

edhe nga ajo psikologjike që ta vazhdojmë rrugëtimin tonë drejt inkuadrimit në elitë. Do ta mbajmë pozitën e dytë deri në fund dhe të inkuadrohemi drejtpërdrejt, pa pasur nevojë të luajmë në ndeshjet e barazhit", ka thënë Arifaj.

Skuadra e Dukagjinit ka shtatë pikë më pak se skuadra e parë në tabelë, Vushtrria dhe kjo diferencë e pikëve mund të ndryshohet pasi në javën e 28 Arifaj paralajmëron fitore ndaj kryesuesve në Ligën e Parë. "Ndeshja me Vushtrinë do të jetë ndeshje shumë e vështirë për të dyja skuadrat. Ata kanë një skuadër me kualitet të lartë, por ne si në çdo ndeshje tjetër hyjmë për fitore dhe besoj se do t'ia arrijmë qëllimit me një angazhim maksimal", ka shtuar ai.

Ish-sulmuesi i Istogut, Lirisë, Drenicës dhe Feronikelit, Granit Arifaj, së bashku me Dukagjin Gashin, Mark Milicajn, Altin Merlakun dhe lojtarë të tjerë, e kanë lënë Superligën për Ligën e Parë për ta ndihmuar skuadrën e Dukagjinit për ta arritur synimin që ka për inkuadrimit në Superligë. "Nuk kam qenë asnjëherë pishman që e kam zgjedhur këtë skuadër. Kjo zgjedhje do të na shpaguehet të gjithëve që e kemi lënë Superligën kur Dukagjini e siguron inkuadrimit në rangun më të lartë të futbollit në Kosovë", ka shtuar ai.

Në xhiron e radhës Dukagjini i shkon Bashkimit, pastaj e pret Vushtrinë. Në xhiron e parafundit i shkon 2 Korrikut në kryeqytet dhe në ndeshjen e fundit e pret Drenasin në Klinë.

## SHKURT

### Kosova U16 fitoi turneun zhvillimor të UEFA-s

Përfaqësuesja e Kosovës U16 në konkurrencën e femrave ka dalë fituese në turneun zhvillimor të UEFA-s që u mbajt në Estoni. Kosova edhe në ndeshjen e tretë të këtij turneu shënoi me rezultat bindës 5-1 në duel me Lihtenshtajnin. Rezultatit e ndeshjes e zhblokoi Loreta Lulaj me golin e shënuar në minutën e 20, me të cilin rezultat edhe u mbyll pjesa e parë. Rezultatit në 2-0 e shtoi Alketa Rama në minutën e 61-të. Më pas ishin futbollistet e Lihtenshtajnit që shënuan për ta ngushtuar epërsinë në 2-1. Në minutën e 73-të, Njomza Osmani shënoi për 3-1, kurse tre minuta më vonë Albulena Guri shënoi për 4-1. Ndërkaq, rezultatit përfundimtar e vulosi Lumbardha Misini në minutën e 80.

### Dy klube angleze në kërkim të Rexhbecajt

Talenti i Wolfsburgut me prejardhje nga Kosova, Elvis Rexhbecaj, ka tërhequr vëmendjen e dy skuadrave nga Anglia. 21-vjeçari në vitin 2017 ka debutuar për skuadrën e parë të Wolfsburgut në Bundesligë, për t'u konsideruar një nga lojtarët më premtues për klubin elitari gjerman. Gazeta gjermane 'Bild' raporton se skuadra e promovuar në Premierligë këtë sezon, Norwich City dhe Leeds United, janë të interesuara për lojtarin nga Prizreni.

### Mulleri në 'radar' të Milanit dhe Interit

Mesfushori i Bayern Munchen, Thmoas Muller, po kërkohet nga dy skuadra të Serisë A. "Kicker" raporton se Milani dhe Interi janë të interesuar të nënshkruajnë me mesfushorin 29-vjeçar. Mulleri nuk është shumë i lumtur në Bayern dhe një lëvizje e re gjatë verës mund të ndodhë. Mulleri është pjesë e skuadrës së parë të Bayernit nga viti 2008 dhe në 315 paraqitje ka shënuar 110 gola.

### Van Dijku: Jam i lumtur që nuk luaj në Spanjë


Performanca e Lionel Messit e ka mahnitur edhe mbrojtësin e Liverpoolit, Virgil Van Dijk. Holandezi ka thënë se skuadra angleze humbi nga lojtari më i mirë në botë, kurse është i lumtur që nuk luan në Spanjë për shkak të Messit. "Liverpooli nuk humbi ndaj Barcelonës, por humbi ndaj Lionel Messit. Nuk është turp ta pranosh humbjen kundër lojtarit më të mirë në botë. Është një talent unik. Kur Messi është në formën e tij më të mirë dhe ti je përballë, nuk mund të bësh absolutisht asgjë. Jam i lumtur që nuk luaj në Spanjë, pasi do të më duhej të përballesh çdo sezon kundër tij. Shënoi dy gola dhe jam totalisht i zhgënjyer", ka deklaruar Van Dijk.

## 'Artmotion' sjell përballjen Robin Krasniqi - Stefan Hartel

**PRISHTINË, 2 MAJ** - Edhe një ngjarje e madhe sportive vjen ekskluzivisht në ekranet televizive përmes platformës 'Artmotion'. Të shtunën, më 11 maj, me fillim nga ora 22:00, drejtpërdrejt nga Stadthalle të Magdeburgut në Gjermani,

'Artmotion' sjell ekskluzivisht përmes kanalit 'Art Sport 1' ndeshjen mes Robin Krasniqit kundër Stefan Hartelit. Për herë të dytë brenda gjashtë muajve në betejën e tij të 55-të profesionale, Robini mbron titullin e kampionit të Evropës në kategorinë

super të mesme. Harteli i paraparë si kundërshtar për nëntorin e kaluar, u tërhoq për shkak të lëndimit, ndërsa Robini mbrojti titullin kundër spanjollit të fuqishëm Hartel. Tash është koha për duelin e shumëpritur Krasniqi - Hartel.



## Messi: Rezultat i mirë, po asgjë nuk ka përfunduar

BARCELONË, 2 MAJ - Leo Messi shënoi dy gola në ndeshjen ndaj Liverpoolit në kuadër të gjysmëfinale së parë në Ligën e Kampionëve. Ai ka thënë se rezultati 3-0 është i mirë, po ende asgjë nuk ka përfunduar për faktin se janë edhe 90 min-

uta për t'u zhvilluar në Angli. "U futëm në lojën e tyre me ritëm të shpejtë dhe fizikë të fortë. Nuk jemi mësuar të mos e kemi topin dhe kjo na kushtoi pak", ka thënë Messi. "Rasti i fundit i Demeles ishte shumë i pastër, katër gola do

të kishin qenë shumë më mirë se tre, por rezultati është i mirë. E dimë që asgjë nuk është mbyllur. 'Anfield' është një fushë e vështirë. Ata ushtrojnë presion, por jemi të lumtur me këtë ndeshje. E rëndësishme është që nuk na

shënuan. Në pjesën e parë ne ishim superiorë, ndërsa në të dytën ata ushtrojnë presion, por nuk patën shumë shanse. E qartë që ata po luftonin për të shënuar një gol, por ky avantazh na jep qetësi", ka deklaruar Messi.



## Ministri Gashi: Kualifikimi në Botëror, sukses i jashtëzakonshëm dhe historik



PRISHTINË, 2 MAJ - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të enjten në takim drejtuesit e Federatës së Hendbollit të Kosovës, të udhëhequr nga kryetari Eugen Saraçini, si dhe hendbollistët e Përfaqësueses së Kosovës në kategorinë U21 në konkurrencën e meshkujve, pas fitimit të së drejtës për të marrë pjesë në Kampionatin Botëror që do të mbahet në Spanjë nga 15-29 korrik 2019.

Ministri i uroi hendbollistët për këtë sukses dhe u dëshiroi suksese në këtë kampionat. "Kualifikimi juaj për Kampionatin Botëror në Spanjë është sukses i jashtëzakonshëm dhe historik. Dua t'ju rikujtoj se e keni përkrahjen time si ministër, por edhe të Ministrisë që unë drejtoj, pavarësisht prej rezultateve që do të sillni nga ky kampi-

onat. Vetë pjesëmarrja juaj në Kampionatin Botëror në Spanjë është një sukses i madh sepse bën të mundur që Kosova të jetë në mesin e 24 shteteve më të mira botërore", ka thënë ministri Gashi.

Ai vlerësoi lart sukseset e Federatës së Hendbollit të Kosovës dhe punën e hendbollistëve të talentuar që kanë bërë që Kosova të jetë e kualifikuar në Botëror. "Është e kuptueshme se për të ardhur deri te ky kualifikim është bërë një punë e palodhshme dhe e suksesshme nga ana juaj duke arritur fitore të shumta. Këtu dua ta theksoj punën e shkëlqyer të Federatës së Hendbollit të Kosovës në organizimin e IHF Trophy Intercontinental që u mbajt gjatë muajit prill në Prishtinë sepse

dihet se edhe nga Federata Ndërkombëtare, por edhe nga federatat e tjera pjesëmarrëse në gara, kjo ngjarje e madhe sportive u quajt kampionat i jashtëzakonshëm", ka shtuar ministri Gashi. Ndërkaq kryetari i FHK-së, Saraçini, u shpreh i entuziazmuar me arritjen e këtij suksesi dhe pjesëmarrjen e hendbollistëve të Kosovës në këtë ngjarje. Drejtuesit e federatës dhe hendbollistët e falënderuan ministrin për pritjen dhe për gatishmërinë për të qenë në përkrahje të hendbollistëve dhe thanë se shpresojnë se nga Kampionati Botëror të kthehen me fitore. Po ashtu, ata theksuan edhe nevojën për krijimin e kushteve për përgatitje për hendbollistët e talentuar të cilët e shkruan historinë e re në sportin e Kosovës.

## Portlandi mposhti Denverin

DENVER, 2 MAJ - Portland Trail Blazersi ka vendosur baraspeshën me Denver Nuggetsin, pasi ka fituar me rezultatin 90-97. Mysafirët e nisën mirë takimin e dytë, duke arritur të krijojnë një diferencë prej 15 pikësh pas dy periodave të para. Reagimi i Nuggetsit në periodën e tretë hasi në rezistencën e Blazersit, që shënoi një pikë më pak se kundërshtari. Vendësit në periodën e fundit e ngushtuan rezultatin në 7 pikë, por pa mundur ta përmbysnin. C. J. McCollum ishte lideri i Blazersit në këtë ndeshje. Ai shënoi 20 pikë, ndërkohë që asistoi 6 asistime dhe rebounde. Enes Kanter dhe Rodney Hood shënuan nga 15 pikë, kurse Damian Lillard 14. Nga ana



### GJYSMËFINALET E KONFERENCAVE

Denver Nuggets-Portland Trail Blazers 90-97 (1-1)

tjetër, Nikola Jokić u ndal në kuotën e 16 pikëve. Serbi asistoi 6 herë si dhe rikuperoi 14 topa na tabelë.

### SHKURT

#### "Marca": Casillasi ka përfunduar karrierën si futbollist

Iker Casillas ka shpëtuar lehtë pas një sulmi në zemër gjatë stërvitjeve të së martës me Porton. Portieri legjendar spanjoll Casillas ishte duke stërvitur kur ka ndier dhimbje në gjoks dhe krahë, e cila i shkaktoi sulmin në zemër. Por, fatmirësisht, pas intervenimit të stafit mjekësor të ekipit portugez dhe dërgimit me urgjencë në spital, portieri tashmë ndihet mirë dhe i ka shpëtuar më së keqes. Megjithatë ka një kontratë valide edhe për një vit e gjysmë, duket se karriera për gardianin ka përfunduar. Sipas burimeve të "Marca"-s, mjekët portugezë kanë pohuar se më 38-vjeçari nuk do të mund të kthehet në fushat e blerta si lojtar profesionist dhe se tashmë duhet të fillojë një jetë të re. Personi është mbi çdo sfidë mjekësore dhe në Porto konsiderojnë se suksesi nuk është kthimi i tij i mundshëm, por kthimi në jetën normale. Ndryshe, Casillasi në të kaluarën ka qenë edhe pjesë e Real Madridit dhe ka fituar gjithçka që është e mundur si lojtar i klubeve dhe me kombëtaren spanjolle.

#### Del Piero: Messi ishte i pushtuar nga djalli!

Ish-kapiteni i Juventusit, Alessandro Del Piero, ka realizuar plot eurogola nga gjuajtjet e lira, por ai i Leo Messit ndaj Liverpoolit është special. Italiani i famshëm ka folur për "Sky Sport" për golat e Messit dhe paraqitjen e tij fantastike në ndeshjen e parë gjysmëfinale. "Mendoj se Messi ishte i pushtuar nga djalli në këtë ndeshje. Edhe goli i parë i Leos nuk ishte i lehtë. Shikoni me çfarë ëmbëlsie e kontrollon topin që kthehet nga traversa. Sa i përket golit të dytë nga 27 metra, të godasësh me atë precizitet dhe forcë (91 km/h shpejtësia e topit) është çmenduri. Kur ke në ekip lojtarë të këtij niveli, në një mbrëmje të Ligës së Kampionëve ata ta fitojnë ndeshjen të vetëm. Alisson? Nuk u vendos mirë, por sinqerisht mendoj se edhe me një lojtar më shumë në mur, asgjë nuk do të kishte ndryshuar. Messi analizoi situatën dhe gjeti zgjidhjen. Sërish do të kishte shënuar", ka thënë Alessandro Del Piero.

#### Pritet shkarkimi i Tuchelit

Paris Saint Germain rinovoi kontratën me trajnerin Thomas Tuchel deri në vitin 2021, por tani po mendon që ta shkarkojë atë. Që nga firma në kontratën e re në muajin mars, situata është përkeqësuar, me PSG-në që nuk fitoi Kupën e Ligës, Kupën e Francës dhe u eliminua nga Liga e Kampionëve. Duke mos arritur dot t'i përmbushte pritshmëritë e larta në kompeticionin evropian, mediet franceze flasin tani për krisje të raporteve mes teknikut dhe klubit parisien.

#### Kloppi: Paraqitje e mirë, por rezultat zhgënjës

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, thotë se është shumë i kënaqur me performancën e ekipit të tij, megjithatë jo edhe me rezultatin. Ekipi i tij pësoi humbje prej 3 me 0 në "Camp Nou" nga Barcelona, me golat e shënuar nga Suarez dhe dy herë shënoi Leo Messi. "Futbolli është kështu. Nuk merrni grada, vetëm rezultate të vështira. Gjithçka ka të bëjë me shënimin e golave. Performanca ishte shumë e mirë, djemtë luajtën një super ndeshje. Kundër një ekipi si Barcelona disa momente janë të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi të mira. Jam shumë i lumtur me performancën, por jo shumë i lumtur me rezultatin, por duhet ta pranojmë këtë", ka thënë Klopp. "Nuk e di nëse mund të luajmë më mirë se aq, të jem i sinqertë. Por, ne do të luajmë sërish. Nuk ka festë në zhvështore, kjo është e sigurt. Nuk ia kemi lehtësuar jetën vetes me rezultatin, por luajmë pas tri ditësh me Newcastle dhe ajo ka më shumë rëndësi", ka deklaruar Klopp.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Statistical Agency of Kosovo*

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenin 6 pika 5 dhe nenin 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofritit të të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, **Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:**

### Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Titulli i pozitës(ave):	Listues i Ekonomive Familjare, Azhurnues i Hartave dhe Mbikqyrës
Tarifa e shërbimit:	<b>Sipas marrëveshjes</b>
Raporton te:	Njësia e GIS/ Hartografisë
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Deri dy muaj
Orari i punës:	1 plotë
Lokacioni dhe numri i intervistuesve:	14 Listues 14 Azhurnues të hartave dhe 4 Mbikqyrës

Në kuadër të bashkëpunimit në mes të Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe Fondacionit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF) për implementimin e Anketës së Treguesve të Shumëfishtë 2019 (MICS) në Kosovë, ASK do të fillojë procesin e Listimit të ekonomive familjare në Qarqet Regjistruese (QR) të përzgjedhura për këtë anketë.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë e ekipit të Azhurnimit të Hartave dhe Listimit të ekonomive familjare

Në linjë me detyrat specifike për listimin e ekonomive familjare dhe Azhurnimin e Hartave sipas gjendjes më të re nga terreni, të përcaktuara në udhëzuesin e MICS-it, listuesit e ekonomive familjare dhe azhurnuesit e hartave do të kenë detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- Të marrin pjesë në trajnimin për procesin e Listimit dhe Azhurnimi e Hartave të ekonomive familjare dhe të marrin pjesë në pilotimin në terren;
- Të identifikojnë kufijtë e çdo QR-es nga harta bazë, dhe përditësojnë informacionin për të reflektuar realitetin në terren (sipas nevojës);
- Në rastin e QR-es është më i vogël, të konsultohen me Mbikqyrësin për vazhdimin e punës;
- Vendosjen në listë të të gjitha strukturave dhe ekonomive familjare në grupim në mënyrë sistematike duke përdorur formularin e listimit të ekonomive familjare;
- Kur nuk ekziston një sistem i adresës, të shënojnë informata identifikuese për ekonominë familjare sipas Manualit për Listim dhe Azhurnim të Hartave;
- Të bëhet Azhurnimi i Hartës së QR-se me gjendjen më të re nga terreni;
- Të plotësojnë të gjithë formularët për Listim të ekonomive familjare dhe hartat;
- Të transferojnë të gjithë formularët e plotësuar dhe hartat tek Mbikqyrësi ose në zyrën qendrore;
- T'i komunikojnë Mbikqyrësit problemet që mund të ndodhin në terren dhe të ndjekin udhëzimet e tij / saj.

#### Përgatitja shkollore dhe përvoja:

- Të ketë të përfunduar së paku shkollën e mesme;
- Të ketë përvojë në punë të azhurnimit të hartave dhe intervistime të ngjajshme (e deshirueshme).

#### Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi shumë të mirë për të komunikuar dhe bashkëpunuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi të orientimit në hapësirë (përdorimi i hartave në hapësirë për identifikimin e objekteve të banimit);
- Aftësi të mira organizative dhe sipas nevojës, të jetë i gatshëm të punojë me orarë pune fleksibil;
- Të jetë nga rajoni përkatës ku do të zhvillohet aktiviteti i listimit.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë e Mbikqyrësve

Në linjë me detyrat specifike për mikqyrësit, të përcaktuara në udhëzuesin e MICS-it mbikqyrësit e Listimit të ekonomive familjare dhe Azhurnimit të Hartave do të kenë detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- Të marrin pjesë në trajnimin për procesin e Listimit dhe Azhurnimi e Hartave të ekonomive familjare dhe të marrin pjesë në punën praktike në terren;
- Shpërndarja e materialit të nevojshëm për listim tek Listuesit/Azhurnuesit;
- Mban kontakte ditore me Listuesit/Azhurnuesit e vetë;
- Monitorimi i punës në terren –Listimi i ekonomive familjare dhe Azhurnimi i QR-se sipas udhëzimeve të MICS-it;
- Ndihmon në rastet të veçanta Listuesit/Azhurnuesit në identifikimin e QR-se;
- Bënë kontrollimin e materialit në aspektin e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes;
- Bënë raporte ditore dhe javore për ASK dhe Unicef;
- Në rastet e QR-es është me i madhë, Mbikqyrësi duhet të asistojë ekipet në terren për ndarjen e QR-se në bashkëpunim me stafin e ASK-së – sipas udhëzimeve të MICS-it;
- Në rastin e refuzimeve të mëdha brenda një QR-es, Mbikqyrësi duhet të bëjë përpjekje për gjetjen e menyrës së marrjes së informative;
- Mbledhja e materialit nga Listuesit/Azhurnuesit, kontrollimi dhe dorëzimi i tyre në ASK.

#### Përgatitja shkollore dhe përvoja:

- Të ketë të përfunduar Fakultetin;
- Të ketë përvojë në punë të azhurnimit të hartave dhe intervistime të ngjajshme;
- Të ketë përvojë menaxheriale.

#### Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi shumë të mirë për të komunikuar dhe bashkëpunuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi të orientimit në hapësirë (përdorimi i hartave në hapësirë për identifikimin e objekteve të banimit);
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe sipas nevojës, të jetë i gatshëm të punojë me orarë pune fleksibil;
- Aftësi kompjuterike, Word, Excel, Internet etj;
- Të jetë nga rajoni përkatës ku do të zhvillohet aktiviteti i listimit.

#### Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Web-faqen e ASK-së .**

#### Numri i anketuesve/intervistuesve sipas regjionit:

Regjioni	Listuesit	Azhurnuesit e Hartave
Gjakovë	2	2
Gjilan	1	1
Ferizaj	2	2
Prishtinë	4	4
Mitrovicë	1	1
Pejë	2	2
Prizren	2	2
<b>Gjithsej</b>	<b>14</b>	<b>14</b>

#### Numri i Mbikqyrësve sipas regjionit:

Regjioni	Mbikqyrës
Gjakovë	1
Prizren	1
Gjilan	1
Ferizaj	1
Prishtinë	1
Mitrovicë	1
Pejë	1
<b>Gjithsej</b>	<b>4</b>

#### Paraqitja e kërkesave:

Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-së, ose mund të shkarkohen nga web faqja e ASK-së në adresën: <http://ask.rks-gov.net/>  
Aplikacionet dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr. "Zene Salihu" Nr.4 Prishtinë.

#### Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten:

CV, kopja e letërnjoftimit, diploma e shkollës së mesme, Fakultetit (Për mbikqyrësit), (të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje).  
Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.  
Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshirohen intervistës me gojë.  
Për informata më të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 200 31 149 apo 038-200 31 154 prej orës 08:00 – 16:00.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Statistical Agency of Kosovo

Na osnovu člana 8. stava 3.1, člana 6, stava 5 i člana 33 Zakona br.04 / Z-036 o Zvaničnoj Statistici Republike Kosovo, Administrativnog Uputstva br.08 / 2012 o Uslovima i Načinu Pružanja Statističkih Podataka Dobijenih Posebnom Obradom Zvaničnih Statistika i člana 12 stava 4 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova, Zakona br. 04 / Z-077 o Obligacionim Odnosima, Agencija za Statistiku Kosova, raspisuje:

### Javni Konkurs o Sporazumu za Posebne Usluge

Naziv institucije:	<b>Agencija za Statistiku Kosova</b>
Naziv pozicije:	Popisivač domaćinstava, Ažurant Mapa i Supervizor
Tarifa usluga:	<b>Po dogovoru</b>
Izveštava:	Jedinica GIS-a/Kartografije
Vrsta ugovora:	Sporazum za Posebne Usluge-(SPU)
Trajanje ugovora:	Do dva meseca
Radno vreme:	Puno
Lokacija i broj izvršilaca:	14 Popisivača domaćinstava 14 Ažuranta Mapa i 4 Supervizora

U okviru saradnje između Agencije za Statistiku Kosova i Dečjeg Fonda Ujedinjenih Nacija (UNICEF) za sprovođenje Istraživanja Višestrukih Pokazatelja 2019 MICS-a na Kosovu, ASK će započeti proces popisivanja domaćinstava u Popisnim Krugovima (PK) koji su odabrani za ovu anketu.

#### Zadaci i odgovornosti tima za ažuriranje mapa i popisivanje domaćinstava

U skladu sa specifičnim zadacima za popisivanje domaćinstava i ažuriranje mapa prema najnovijem stanju, kao što je navedeno u priručniku MICS-a, popisivači domaćinstava i ažuriranja mapa će imati sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Učestvuje u obuci i upoznaje se sa Popisivanjem i ažuriranjem Mapa domaćinstava i da učestvuju u pilot/probnu anketu na terenu
- Identifikacija granice svakog PK-a iz osnovne mape i ažuriranje podataka kako bi odražavale realnost na terenu (po potrebi)
- U slučaju kada PK je manji, da se konsultuje sa Supervizorom za nastavak rada;
- Popisuje sve strukture i domaćinstva u grupi sistematski koristeći obrazac za popis domaćinstava
- Kada ne postoji sistem adresa, treba da napiše identifikacione informacije o domaćinstvu u skladu sa Priručnikom za Popisivanje i Ažuriranje Mapa;
- Ažurira Mapu PK-a prema najnovijoj situaciji na terenu;
- Popuni sve obrasce za popis domaćinstava i mapa;
- Prenese sve popunjene obrasce i mape kod Supervizora ili u Centralnoj kancelariji
- Obavesti Supervizora o problemima koji se mogu pojaviti na terenu i prati uputstva supervizora.

#### Školska sprema i iskustvo:

- Da ima najmanje završenu srednju školu.
- Da ima radno iskustvo u ažuriranju mapa i sličnim intervjuima (poželjno).

#### Kompetencije i veštine:

- Veoma dobru saradnju i komunikacione veštine;
- Spreman/na za temski rad;
- Sposobnost prostorne orijentacije( korišćenje mapa za prostornu identifikaciju stambenih objekata);
- Dobre organizacijske sposobnosti i, po potrebi, spremnost za fleksibilan rad;
- Da bude iz odgovarajućeg regiona gde će biti sprovedeno popisivanje.

#### Zadaci i odgovornosti supervizora:

U skladu sa specifičnim zadacima supervizora, kao što je navedeno u priručnika MICS-a, supervizori popisivanja domaćinstava i ažuriranja mapa će imati sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Učestvuje u obuci i upoznaje se sa procesom popisivanja i ažuriranja Mapa domaćinstava i da učestvuju u praktični rad na terenu;
- Distribuirati potrebni materijal za popisivanje kod Popisivača / Ažuranta;
- Održava svakodnevne kontakte sa svojim popisivačima/ažurantima;
- Prati rad na terenu - Popisivanja domaćinstava i ažuriranja PK-a u skladu sa priručnikom MICS-a;
- Pomaže u posebnim slučajevima Popisivače /Ažurante u identifikaciju PK-a;
- Vršiti kontrolu materijala u pogledu kvaliteta i sveobuhvatnosti;
- Izrađuje dnevne i sedmične izveštaje za ASK i UNICEF;
- U slučajevima kada PK je veći, Supervizor treba da pomogne timovima na terenu u podele PK u saradnji sa službenicima ASK – prema smernicama MISC-a;
- U slučaju većih odbijanja unutar jednog PK-a, Supervizor treba da se potruži da pronade način za dobijanje informacija;
- Preuzimanje materijala od Popisivača /Ažuranta, kontrola i dostavljanje materijala u ASK.

#### Školska sprema i iskustvo:

- Da ima završeni fakultet;
- Da ima iskustvo u ažuriranju mapa i sličnim intervjuima;
- Da ima iskustvo u upravljanju.

#### Kompetencije i veštine:

- Veoma dobru saradnju i komunikacione veštine;
- Spreman/na za temski rad;
- Sposobnost prostorne orijentacije( korišćenje mapa za prostornu identifikaciju stambenih objekata);
- Dobre organizacijske sposobnosti i, po potrebi, spremnost za fleksibilan rad;
- Poznavanje rada na računaru word, excel, internet itd
- Da bude iz odgovarajućeg regiona gde će biti sprovedeno popisivanje.

#### Uslovi učešća na konkursu:

Pravo učešća na konkurs imaju svi punoletni (stariji od 18.godina) Građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

**Konkurs je otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima i na veb- stranici ASK-a. (03-10.05.2019 ).**

#### Broj anketara/popisivača prema regionu:

Regioni	Popisivači	Ažuranti mapa
Dakovica	2	2
Gnjilane	1	1
Uroševac	2	2
Priština	4	4
Mitrovica	1	1
Peć	2	2
Prizren	2	2
<b>UKUPNO</b>	<b>14</b>	<b>14</b>

#### Broj supervizora prema regionu:

Regioni	Supervizori
Đakovica	1
Prizren	1
Gnjilane	1
Uroševac	1
Priština	1
Mitrovica	1
Peć	1
<b>Ukupno</b>	<b>4</b>

#### Podnošenje prijave:

Obrasci za prijavu mogu se dobiti U Arhivi ASK-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice ASK-a: <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacije se dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova, Ul."Zcncl Salihu" br.4, Priština.

#### Uz aplikaciju potrebno je priložiti:

CV, Kopiju lične karte, diplomu srednje škole, diplomu fakulteta (za poziciju supervizora), (svi dokumenti treba da budu kopije).

Nepotpune prijave i one *podnete* nakon isteka roka *neće* biti prihvaćene

Zbog velikog broja primljenih prijava, *samo kandidati* koji uđu u *uži izbor* *biće* kontaktirani.

Kandidati koji uđu u *uži izbor* *biće* intervjuisani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju Osoblja na broj telefona: : 038- 200 31 149 ili 038-200 31 154 od 08:00 – 16: 00 časova.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**  
**Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit**  
**Ministarstvo Infrastrukture i Transporta**  
**Ministry of Infrastructure and Transportation**

## SHPALLJE E KONKURSIT

**Institucioni:** Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit

**Institucija:** Ministarstvo Infrastrukture i Transporta

**Institucioni/institucija** MIT/MIT **kërkon të punësojë** (titullin e pozitës) në(departamentin/drejtoratin/divizionin,njësinë) e /zeli da regrutuje (naziv posla u odeljenju/direkciji,diviziji ili sektoru) **Departamenti i Inspektimit /Departman Inspekcije**

**Titulli i vendit të punës /Naziv radnog mesta:** Udhëheqës/e i/e Divizionit të Inspektimit të Autoskollave/ Rukovodilac Divizije za inspektovanje Auto škola

**Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës?** Niveli Drejtues dy (2), grada gjashtë (6), (BKK 9)

**Funkcionalna kategorija i stepen radnog mesta/ Nivo upravljanja dva (2)-stepen plate šest (6), (BKK 9)**

**Numri i referencës së vendit të punës/Broj radnog mesta/RN00004794**

(Shënoni saktësisht por me pak fjalë detyrat dhe përgjegjësitë kryesore)/(Naznačite tačno i kratkim rečima glavne odgovornosti):

- Udhëheq punën e gjithëmbarshme të divizionit dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe hartimin e planit të punës për përbushjen e këtyre objektivave
- Inspekton dhe konstaton gjendjen momentale të auto shkollave të licencuara si dhe a janë duke ju përmbajtur planprogramit të paraparë me akte ligjore
- Rekomandon dhe udhëzon auto shkollat për përmirësimin dhe eliminimin e të metave të cilat vërehen gjatë inspektimit
- Inspekton lokalet, pajisjet, automjetet, instruktorët në teren dhe mbajtjen e evidencave dhe dokumentacionit administrativ i cili duhet të mbahet gjatë kryerjes së punëve të përditshme në auto-shkolla
- Ndërprenë punën e auto-shkollave të cilat veprojnë në kundërshtim me dispozitat e ligjit në fuqi dhe akteve nën ligjore të cilat rregullojnë këtë sektor
- Inicon procedurën për revokimin e licencës së auto-shkollës në rast se nuk vazhdon t'i përmbahet kushteve të parapara për licencim
- Inicion procedurat konform legjislacionit në fuqi në gjykatën me kompetencë përkatëse
- Kryen të gjitha detyrat tjera sipas kërkesave të Drejtorit të Departamentit
- Rukovodi sve obuhvatnim radom divizije i pomaže na dzorniku u određivanju ciljeva i izradi plana rada za ispunjavanje ovih ciljeva
- Inspektuje i konstatuje momentalno stanje licenciranih auto školakao i dali se pridržavaju plana i programa predviđenog zakonskim aktima
- Predlaže i upućuje auto škole za poboljšanje i otklanjanje nedostataka koji se primećuju prilikom inspektiranja
- Vrš i inspekciju lokala, opreme, motorna vozila, instructor e na terenu i vođenje evidencije i administrativne dokumentacije koja treba da se void tokom obavljanja svako dnevnih poslova u auto školama
- Obustavlja rad auto škola koje postupaju protivno zakonskim odredbama na snazi i drugih podzakonskih akata koje uređuju ovaj sektor
- Pokreće procedure za opoziv licence auto škole u slučaju kada se ne pridržava uslovima predviđenim za licenciranje
- Pokreće procedure saglasno zakonodavstvu na snazi u sudu odgovarajuće nadležnosti
- Obavlja sve druge dužnosti na zahtev od direktora Odeljenja

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim-Uslovi za učesće na regrutaciji**

(Shënoni kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit sipas ligjit për shërbimin civil/Navedite uslove za učesće u procesu regrutacije po Zakonu Javne Službe/

**Procedurat e konkurrimit-Procedure konkurisanja**

Shënoni nëse procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatë të jashtëm si dhe nëpunës civilë ekzistues ose nëse është procedurë e brendshme vetëm për nëpunës civilë ekzistues - Navedite da li je procedura konkurisanja javna za spoljne kandidate, ili da li je procedura interna samo za postojeće civilne službenike

**Procedura e konkurrimit është e hapur për gjithë kandidatet te jashtëm si dhe për nëpunës civil/ Procedura konkurisanja je objepljena i za javne sluzbenike koji rade u intitucije .**

**Shkollimi i kërkuar/Minimum obrazovanja koje se zahteva:**

(Shënoni shkollimin që kërkohet realisht për këtë vend pune/(Navedite stepen obrazovanja koje se realno traži za ovo radno mesto)/

- **Diplomë universitare: Fakulteti Juridik, Komunikacionit**
- **Univerziteteska Diploma: Pravni i Saobracajni Fakultet**

**Aftësitë,përvoja dhe atributet tjera që kërkohen/Veštine, iskustvo idruga osobine koje se zahtevaju.**

(Përshkruaj aftësitë, përvojën dhe vetitë personale të cilat janë të kërkuara dhe të cilat mund të jenë të dëshiruara.Këto duhet të kenë lidhje me punën dhe të jenë objektive./((Opišite sposobnosti, iskustvo i lične osobine koje se zahtevaju kao i one koje su poželjne. One moraju da budu povezane sa radon i da budu objektivne.

- Diplomë universitare: Fakulteti Juridik, Komunikacionit,
- Pesë (5) vite përvojë pune profesionale
- Shkathësi të shkëlqyera në menaxhim
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit)
- Univerziteteska Diploma: Pravni i Saobracajni Fakultet
- Pet (5) godina stručnog radnog iskustva
- Odlične veštine u upravljanju
- Sposobnost obavljanja dužnosti i poslova pod pritiskom
- Računarske veštine u aplikacijama programa (Word, Excel, Power Point, Internet)

**Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin/ Zakonski i podzakonski akti koji regulišu zaposljavanje.**

(Shënoni një përshkrim të shkurtë të përzgjedhjes dhe të rregulloreve ekzistuese që rregullojnë rekrutimin - Navedite kratak opis izbora i postojećih pravilnika koji regulišu zapošljavanje

**Nëpunësit e shërbimit Civil të Republikës së Kosovës i nënshtrohen Sipas Ligjit për Shërbimin Civil Nr. 03/L-149/Zakona Br.03/L-149 o Javnoj Službi, - Rregullorja nr 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë/ Uredba br. 21/2012 O Napredovanju u Karijeri Civilnih Službenika**

**Rregullores nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës dhe standardeve të sjelljes dhe etikes të përshkruara në kodin e mirësjelljes së shërbimit civil/Uredbe br. 02-2010 o procedurama regrutacije u Civilnu Službu Kosova i standardima ponašanja i etikeopisanih u kodeksu ponašanja civilne službe**

**Kohëzgjatja e emërimit/ Vremenski rok imenovanja:**

**Kohëzgjatja e kontratës PA AFAT I KARRIERES**

(Naznačite ako je imenovanje na odredjeno ili na neodredeno vremei vremenski rok)

**Data e mbylljes së konkursit/Datum zatvaranja konkursa:**

(Shënoni kohëzgjatjen e konkursit dhe datën e mbylljes/ Naznačite vremenski rok trajanja konkursa i krajni rok)

**Prej 03.05.2019 deri 17.05.2019 në ora 16:00/ od 03.05.2019 do 17.05.2019 u 16:00 časova**

**Paraqitja e kërkesave/Prijeva zahteva**

(Shënoni vendin ku dhe kur mund të merren formularët e aplikacionit si dhe vendin ku duhet të dorëzohen dhe adresa e plotë e institucionit pranues) / ( Navedite kako i gde se mogu dobiti obrasci za konkurisanje, mesto gde ih treba predati kao i tačna adresa institucije koja će ih primiti)

**Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, Rr. Nëna Terezë, Ndërtesa e ish-Gërmisë, kati II – zyra A 204/ Ministarstvo Infrastrukture i Transporta, Trg Majka Tereza, Bivša zgrada Germije, II sprat, kancelarija br. A204**

**Kërkesat specifike/ Specifični zahtevi**

(Shënoni nëse ka ndonjë kërkesë specifike shëndetësore ose fizike për kryerjen e detyrave të punës, përfshirë kërkesën për vlerësim mjekorë)/(Navedite ako ima neki specifičan zahtev zdravstvene ili fizičke prirode za izvršavanje radnih obraveza, uključujući zahtev za lekarsko mišljenje).

**"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë/Kosovska javnana sluzba pruža jednake uslove zapošljavanja za sve državljane Kosova i prima aplikacije svih lica muškog i ženskog roda iz shih zajednica na Kosovu.**

**"Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtaret e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 te Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës",-Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju prava da budu predstavljani prporcionalno na organima Javne službe na lokalnom i centralom nivou, kao što je naznačeno i Čl.11, paragraf 3 Zakona Br.03/L-149 o Javnoj Službi Republike Kosovo.**


Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen/Zahtevi postati nakon zatvaranja konkursa neće se uzeti u obzir. Nekompletirani zahtevi mogu biti odbijeni.


Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen/Zbog velikog broja dobijenih zahteva, biće pozvani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.


Shënoni emri dhe mbiemri, numri i telefonit të personit i cili mund të kontaktohet në rast të ndonjë pyetjeje/ Napišite ime, prezime i broj telefona osobe koju treba kontaktirati u slučaju bilo kakvih nedoumica;

**Nr (038) 200 28 498 ose (038) 200 28 547**

**TOP**  
**PAKO**

 Komunikim **FALAS**

 Internet deri në **50Mbps**

 Televizion Digjital

*Për vetëm 17euro*

## TOP PAKO, PËR TË GJITHË!

TOP Pakot përmbajnë të gjitha shërbimet e nevojshme të komunikimit për biznese të vogla por edhe për familje.

Prej vetëm 17.00€, **10 numra me komunikim FALAS**, PLUS:

- ∞ minuta drejt IPKO-së;
- ∞ SMS;
- Internet në mobil deri në 5GB;
- Televizion digjital dhe Internet deri në **50Mbps**;
- Telefoni Fikse me tarifa standarde;

Për më shumë informata, vizitoni dyqanin më të afërt të IPKO-së.

[WWW.IPKO.COM](http://WWW.IPKO.COM)

